



**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**

---

# RAPORTI VJETOR **2012**

DHE

# SYNIMET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN **2013**

**AUTORITETI I KONKURRENCËS**

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4,  
Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: [caa.gov.al](http://caa.gov.al)

Email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                               |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Fjalim përshendetës i Kryetarit të Komisionit .....</b>                                    | <b>3</b>  |
| <b>I. Zhvillimet kryesore të zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës.....</b>        | <b>5</b>  |
| I.1 Karakteristikat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës .....                       | 5         |
| I.2 Përmbledhje e zhvillimeve kryesore .....                                                  | 6         |
| <b>II. Zbatimi i ligjit të konkurrencës .....</b>                                             | <b>11</b> |
| II.1 Administrimi i ankesave .....                                                            | 11        |
| II.2 Marrëveshjet e ndaluara (kartelet) .....                                                 | 17        |
| II.3 Përfshirje nga ndalimi i marrëveshjeve .....                                             | 24        |
| II.4 Abuzimi me pozitën dominuese .....                                                       | 26        |
| II.5 Kontrolli i përqendrimeve .....                                                          | 28        |
| II.6 Monitorimet e tregut .....                                                               | 32        |
| II.7 Kontrolli gjyqësor i Çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës .....                      | 37        |
| II.8 Përafrimi i legjislacionit .....                                                         | 38        |
| <b>III. Advokatia dhe kultura e konkurrencës.....</b>                                         | <b>40</b> |
| III.1 Vlerësimi i akteve dhe draft-akte normative.....                                        | 40        |
| III.2 Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe udhëzues mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës ..... | 44        |
| III.3 Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat .....                      | 45        |
| <b>IV. Bashkëpunimi ndërkombëtar .....</b>                                                    | <b>47</b> |
| IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin Europian .....                                                | 48        |
| IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest) .....                                               | 51        |
| IV.3. Bashkëpunimi me ICN dhe Autoritet e Rajonit .....                                       | 51        |
| <b>V. Burimet njerëzore dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës .....</b>                | <b>53</b> |
| V.1 Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës .....                 | 53        |
| V.2 Struktura organizative.....                                                               | 54        |
| V.3 Rritja e kapaciteteve administrative.....                                                 | 55        |
| V.4 Manaxhimi financiar.....                                                                  | 55        |
| <b>VI. PRIORITETET PËR VITIN 2013 .....</b>                                                   | <b>57</b> |
| VI.1. Zbatimi i ligjit të konkurrencës .....                                                  | 57        |
| VI.2 Përafrimi i legjislacionit .....                                                         | 58        |
| VI.3 Forcimi i advokatisë dhe i kulturës së konkurrencës.....                                 | 58        |
| VI.4. Forcimi i kapaciteteve administrative .....                                             | 59        |
| Shtojcë 1-Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve.....   | 60        |
| Shtojcë 2: Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni deri më 31 Dhjetor 2012.....       | 61        |
| Shtojcë 3 - Përqëndrimet e njoftuara dhe të autorizuar .....                                  | 62        |
| Shtojcë 4- Lista e vendimeve të Komisionit për ekzekutimin e gjobave .....                    | 63        |
| Shtojcë 5- Pasqyra e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit.....                      | 64        |
| Shtojcë 6-Matrica e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni dhe zbatimi i tyre .....             | 66        |
| Shtojcë 7-Struktura e Autoritetit të Konkurrencës.....                                        | 69        |
| Shtojcë 8- Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2012 .....                       | 70        |

## FJALIM PËRSHENDETËS I KRYETARIT TË KOMISIONIT

Shpesh kohët e fundit politika dhe ekspertët e ekonomisë flasin për reformat strukturore si rruga e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Zbatimi i politikës dhe i ligjit të konkurrencës përbën reformën më efektive dhe me më pak kosto, pasi zbatimi në mënyrë konsistente cdo ditë sjell përfitime të drejtëpërdrejta për biznesin dhe për qytetarët. Efekti i drejtëpërdrejtë i zbatimit të kësaj reforme është rritja e ndjeshmërisë së tregjeve, e cila sjell rritjen eficientëve të përdorimit të burimeve nga shoqëria.

Në këtë këndvështrim, roli dhe kontributi i Autoritetit të Konkurrencës, si mbikqyrësi i lojës së lojtarëve, është shumë jetik për të mbrojtur dhe promovuar konkurrencën efektive në treg, e cila është procesi që e bën një ekonomi eficiente. Nën presionin konkurrues, firmat shkojnë drejt inovacionit për të rritur efikasitetin dinamik nëpërmjet përmirësimeve teknologjike, konkurrimit me produkte apo shërbime të reja duke synuar avantazhin në kosto dhe duke u kthyer në këtë mënyrë në motorin e zhvillimit ekonomik.

Mirëfunksionimi i tregut dhe konkurrenca e lirë e efektive është një nga kushtet e rëndësishme për integrimin e Shqipërisë si anëtar me të drejta të plota në Bashkimin Europian. Për plotësimin e këtij misioni institucioni i konkurrencës ka vepruar duke përmirësuar në mënyrë progresive performancën institucionale si dhe duke forcuar zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nëpërmjet një partneriteti të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe të konsumatorit.

Adresimi gjithnjë e më tepër tek institucioni i konkurrencës mbi shqetësimet apo shenjat e dështimeve të tregut nga ana e biznesit dhe konsumatorit është një tregues i drejtëpërdrejt i realizimit të objektivave në funksion të misionit, por përbën njëkohësisht sfidën kryesore të këtij institucioni. Përmirësimi e sofistikimi i instrumentave të investigimit dhe shkurimi i kohës së realizimit të hetimeve kanë qënë vecoritë e aktivitetit të vitit të kaluar, të cilat kanë çuar në shtimin e ndërhyrjeve në treg të institucionit të konkurrencës.

Përmirësimi dhe përsosja e instrumentave të ndërhyrjeve në treg si dhe rritja e efikasitetit të këtyre ndërhyrjeve vazhdon të jetë një kërkesë e vazhdueshme e një ekonomie me pak eksepriencë krahasuar me historinë e gjatë të ekonomisë së lirë të tregut. Kombinimi në mënyrë sa më optimale të instrumentave të saksioneve, ndaj ndërmarrjeve për praktikant antikorrupsion në formën e marrëveshjeve të ndaluara apo të abuzimit me pozitën dominuese, me advokacinë

dhe kulturën, për promovimin e konkurrencës, ka qënë karakteristika kryesore e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës.

Për nxitjen dhe promovimin e konkurrencës një faktor i rëndësishëm është bashkëpunimi midis aktorëve e faktorve të tregut dhe institucioneve publike. Është e rëndësishme që të kuptohet se konkurrenca është një vlerë e tregut dhe e shoqërisë në përgjithësi. Kjo ka qënë filozofia jo vetëm e bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës me entet rregullatore dhe institucionet e tjera të qeverisjes qëndrore, por e të gjithë rekomandimeve që Komisioni i Konkurrencës i ka dhënë për nxitjen e konkurrencës.

Konsolidimi i shtetit ligjor është një nga sfidat e shoqërisë sonë, dhe padyshim edhe institucioni i konkurrencës, si institucioni që mbron dhe garanton zbatimin e lirisë së tregut si një prej lirive bazë mbi të cilën është ndërtuar shoqëria dhe ekonomia e vendit tonë nuk mund të realizojë misionin e vet jashtë sistemit të së drejtës. Prandaj, karakteristikat pozitive dhe negative të këtij sistemi kushtëzojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë efektivitetin e ndërhyrjeve në treg të institucionit të konkurrencës, i cili si institucion publik mbron interesat e publikut ndaj interesave të ngushta të atyre bizneseve që kërkojnë të realizojnë përfitime nëpërmjet praktikave antikonkurruese.

Është shumë jetike për mirëfunksionimin e tregjeve, që në termat e zakonshëm do të thotë rritja e mirrëqënies së konsumatorit, të përcillet dhe të absorbohet sa më drejtë filozofia e së drejtës së mbrojtjes së konkurrencës nga sistemi i së drejtës. Argumentimi i vendimeve në funksion të mbrojtjes së interesit publik është jo vetëm një detyrim ligjor në zbatim të ligjit, por mbi të gjitha është një detyrim moral pasi çënohet mirëqënia e qytetarit.

## **I. ZHVILLIMET KRYESORE TË ZBATIMIT TË LIGJIT DHE POLITIKËS SË KONKURRENCËS**

Sistemi ekonomik në Shqipëri është saksionuar në nenin 11, pika 1 të Kushtetutës, sipas së cilës “sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike”. Garantimi i kësaj shtylle të Kushtetutës realizohet edhe nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar) dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, institucioni përgjegjës për të cilin është Autoriteti i Konkurrencës. Ky institucion publik funksionon jo vetëm në zbatim të ligjit dhe të politikës së konkurrencës , por edhe të normave dhe praktikave më të mira të administratës publike dhe të së drejtës europiane të konkurrencës.

### **I.1 Karakteristikat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës**

Misioni i Autoritetit të Konkurrencës është në përputhje me qëllimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve.

Për realizimin e misionit të tij për konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, Autoriteti i Konkurrencës zbaton fuqinë dhe instrumentat ligjorë siç janë procedurat investigative dhe hetimore për të zbuluar dhe penalizuar praktikant antikonkurruese që shfaqen në formën: e marrëveshjeve të ndaluara për fiksime dhe çmimeve, ndarjen e tregjeve, kufizimin apo kontrollin e prodhimit; të abuzimit me pozitën dominuese në formën e vendosjes së çmimeve të padrejta, kufizimin e prodhimit apo të shërbimit, vendosja në pozita jo të barabarta e klientëve, apo vendosja e kushteve dhe detyrimeve shtesë në kontratë me palët e treta, si dhe kontrolli i përqëndrimeve për të mos lejuar krijimin ose forcimin e pozitës dominuese. Këto aspekte përbëjnë tre kolonat kryesore të ligjit shqiptar të konkurrencës, i cili është një ligj i përafëruar në një shkallë të gjerë me *acqui-communitaire*, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në instrumentat e zbatimit të tij.

Pjesë e misionit të institucionit të konkurrencës është edhe promovimi dhe nxitja e lojës së lirë të operatorve në treg, i cili realizohet nëpërmjet instrumentit të advokacisë dhe aktivitetit për rritjen e kulturës së konkurrencës. Advokatia e konkurrencës nuk synon thjesht shprehjen e opinionit të Autoritetit të Konkurrencës për aktet ligjore dhe nënligjore, por zbatimin e atij parimi kushtetues që synon promovimin dhe nxitjen e konkurrencës duke kufizuar e eliminuar shtrembërimin apo pengimin e konkurrencës nga aktet ligjore dhe nën ligjore si kuptimin e dhënies së të drejtave ekskluzive/të veçanta ose kufizimeve sasiore në treg.

Autoriteti i Konkurrencës është një institucion publik i pavarur i cili ka si qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Mirefunksionimi i tregjeve sjell përfitime nga konsumatorët duke pasur liri më të madhe zgjedhjeje, çmime më të ulëta dhe produkte e shërbime më cilësore. Pra, misioni i Autoritetit të Konkurrencës është t'i bëjë tregjet konkurruese dhe ekonominë e tregut funksionale, pikërisht në funksion të mirëqenies konsumatore dhe prosperitetit ekonomik të vendit në tërësi.

## **1.2 Përmbledhje e zhvillimeve kryesore**

Gjatë viti 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka vepruar në zbatim të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe ka marrë parasysh rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të konkurrencës për vitin 2012”. Mbështetja dhe inkurajimi i vazhdueshëm nga Kuvendi dhe Komisioni Evropian kanë qënë faktorë të rëndësishëm për rritjen e performancës dhe vlerësimin drejtë të sfidave për një ekonomi sa më konkurruese.

Konsolidimi i **legjislacioni sekondar** në zbatim të amendimeve të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndyshuar), si dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me të drejtën europiane në fushën e konkurrencës ka qënë një nga aspektet e punës së Autoritetit të Konkurrencës. Gjatë vitit 2012, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar kater rregullore, kryesisht rregulloret specifike për përjashtimin në bllok të marrëveshjeve, dhe udhëzuesin për vlerësimin e kontrollit të përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve. Procesi i miratimit të këtyre akteve nënligjore ka qënë transparent dhe është realizuar nëpërmjet konsultimeve publike dhe organizmit të tryezave të rrumbullakta me grupet e interesit. Puna për plotësimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor dytësor, është realizuar në përputhje të Planit Kombëtar të Zbatimit të Masave të Stabilizim - Asocimit dhe në funksion të plotësimit dhe përafrimit të legjislacionit dytësor.

Sikurse është identifikuar edhe në raportimin e vitit të kaluar, institucioni i konkurrencës po konsolidon profilin publik si institucioni që mbron interesat e biznesit, i cili kërkon të zbatojë rregullat e lojës së tregut. Numri i **ankesave** është indiktori i drejtëpërdrejtë i kësaj karakteristike institucionale. Gjatë vitit të kaluar janë depozituar 20 ankesa nga të cilat 14 ankesa kanë patur objekt në përputhje me ligjin kudrejt 6 rasteve të tilla të paraqitura në vitin 2011. Bazuar në objektin e ankesave rezulton se, 7 ankesa janë për marrëveshje të ndaluara apo sjellje të bashkërenduara, 5 ankesa janë për abuzimin me pozitën dominuese të një apo disa ndërmarrjeve, 2 ankesa janë për rishikimin e akteve nënligjore të enteve rregullatore apo të institucioneve të tjera si dhe 6 ankesa që nuk ishin objekt i ligjit

“Për mbrojtjen e konkurrencës”. Tregjet për të cilat adresoheshin këto ankesa ishin kryesisht: prokurimet publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, i telekomunikacionit, i sigurimeve, transporti publik qytetas i udhëtarëve, tregu i shitjes me shumice të vajit vegjetal.

Gjatë vitit 2012 numri i ankesave është afërsisht 2 herë më shumë se një vit më parë. Nga 29 ankesa të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës gjatë viti 2012, 6 ankesa ishin për abuzimin me pozitën dominuese të një/disa ndërmarrjeve, 6 ankesa për marrëveshje të ndaluara, 9 kërkesa për rishikimin e akteve nënligjore të Autoritetit të Konkurrencës dhe institucioneve të tjera si dhe 7 ankesa që nuk ishin objekt i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Tregjet për të cilat adresoheshin këto ankesa ishin kryesisht: prokurimet publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, telekomunikacionit, i sigurimeve, transporti publik qytetas të udhëtarëve, tregun e shitjes së vajit vegjetal.

Bazuar në këto ankesa si dhe në sinjalet e ndryshme të marra nga mediat apo edhe nga shqetësimet e ngritura nga anëtar të Parlamentit Shqipëtar, Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar **monitorime dhe hetime** në disa tregje, si në ato të rregulluara, edhe në tregjet e liberalizuara plotësisht. Më konkretisht:

Kanë përfunduar procedurat hetimore të trashëguara nga viti i kaluar si në tregun e ngarkimit të shkarkimit të gazit të lëngshëm natyror në rrugë detare; tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike; tregun e shërbimit të telefonisë fikse të kartave me parapagesë; tregun e transportit detar të pasagjerve në portin Vlora.

Kanë filluar dhe përfunduar procedurat hetimore në: tregun e sigurimeve;

Janë në përfundim të procesit hetimet e thelluara në tregjet: e prodhimit, importit dhe tregëtimit me shumice të vajit të lulediellit; transportit të udhëtarëve në qytetin e Tiranës; importit, prodhimit dhe të shitjes me shumicë të çimentos rifuxho; tregu i prokurimeve publike të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar janë monitoruar: tregu financiar, me objekt marrëveshjet mes bankave dhe ndërmarrjeve të sigurimit; tregu i farërave e fidanëve, tregu i pesticideve dhe i plerave kimike; monitorimi i tregut të transportit ajror; tregu i importit dhe i shitjes me shumicë të produkteve ushqimore: sheqer, oriz, vaj ushqimor, tregu i importit të grurit; tregu i manaxhimit të mbetjeve urbane në landfill-in e Bushatit; si dhe monitorohen ndryshimet e strukturave të tregut për importuesit e gazit të lëngshëm dhe të karburanteve.

Një nga objektivat kryesore të autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit të kaluar ka qënë rritja e pavarësisë reale bazuar në rritjen e profesionalizimit, përsheptimi i

procedurave si dhe në përmirësimin e **instrumentave investigative** dhe të hetimit. Për herë të parë gjatë vitit 2012 janë realizuar në të njëjtën kohë inspektimet në ndërmarrje të ndryshme dhe është përmirësuar teknika investigative duke shfrytëzuar teknologjinë e informacionit. Në këtë aspekt, sfidë kryesore mbetet rritja e nivelit të qartësisë së raporteve dhe argumentimi juridik i veshur me analiza më të hollësishme ekonomike dhe më bashkëkohore lidhur me shqyrtimin e rasteve.

Gjatë vitit 2012, Autoriteti i Konkurrencës, ka qënë proaktiv për të realizuar detyrimin ligjor të kontrollit të përqëndrimeve, si një instrument i kontrollit për të parandaluar rritjen e përqëndrimeve në tregjet objekt të këtyre ndryshimeve të kontrollit të pronësive. Ky qëndrim është bërë i mundur në saj të bashkëpunimit me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ku bazuar në informacionet mbi transaksionet e ndodhura dhe vlerësimi i tyre nga pikëpamja e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë iniciuar procedurat e kontrollit të përqëndrimeve për katër raste nga vetë institucioni i konkurrencës, transaksione të cilat nuk janë njoftuar nga palët. Gjatë vitit të kaluar, janë shqyrtuar 9 praktika përqëndrimesh lidhur me përfundimin e kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve ose krijimin e një ndërmarrje të re, të cilat kryesisht kanë ndodhur jashtë territorit të Shqipërisë.

Për realizimin e misionit të tij për konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, Autoriteti i Konkurrencës e konsideron jetike bashkëpunimin me entet rregullatore dhe institucionet publike, nëpërmjet të të cilit zbatohet **advokacia**, si shtylla e katërt e ligjit. Për këtë qëllim janë përmirësuar më tej instrumentat e komunikimit jo vetëm në organimin e tryezave të përbashkëta në nivel ekspertësh dhe të bordeve vendimmarrëse por, edhe nëpërmjet takimeve për të ndarë shqetësimet apo opinionet midis drejtuesve të institucioneve. Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë realizuar një sërë rekomandimesh nga Komisioni i Konkurrencës si në tregun e energjisë elektrike dhe atë të gazit, në tregun e komunikimit elektronik, prokurimet publike, tregun e sigurimeve, etj. Krahasuar me vitin paraardhës vihet re se gjatë vitit 2012, është rritur numri i akteve nënligjore të ardhura për mendim pranë institucionit të konkurrencës, nga institucionet shtetërore. Konkretisht nga 10 draft akte të depozituara për mendim në vitin 2011, sivjet janë paraqitur dhe vlerësuar 18 të tilla, pra gati një rritje të këtij treguesi të advokacisë, si një instrument për të mbrojtur, promovuar dhe nxitur konkurrencën nga ndërhyrjet në treg. Duhet theksuar se një rol shumë të rëndësishëm në këtë aspekt ka luajtur theksimi në rezolutën e Kuvendit i kërkesës drejtuar organeve ekzekutive për të bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës për të shmagur miratimin e akteve që sjellin kufizime sasiore për hyrjet në treg dhe tregtimin apo kufizime të tjera sipas parashikimeve të nenit 69 të Ligjit.



Gjatë vitit të kaluar është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Autoritetin e Aviacionit Civil, i cili ka si objekt bashkëpunimin e ngushtë midis institucioneve për të mundur monitorimet mbi faktorët që ndikojnë në mirë funksionimin e këtij tregu; si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit i cili ka si objekt bashkëpunimin për të evidentuar marrëveshjet e ndaluara në prokurimet publike. Gjithashtu, janë realizuar mbi 5 tryeza të rrumbullakta me entet rregullatore apo me institucionet qëndrore, si me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Entin Regullator të Energjisë (ERE), Entin Regullator të Ujit (ERU), Agjencinë e Prokurimeve Publike (APP), etj në të cilat janë diskutuar problematikat e identifikuar gjatë proceseve të monitorimit apo të hetimeve të tregjeve respektive. Nëpërmjet bashkëpunimit me APP-në, Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike si dhe me ekspertet e projektit IPA-2008 u mundësua trajnimi në një numër të konsiderueshëm të nëpunësve të institucioneve publike që realizojnë procedurat e prokurimeve publike mbi kuptimin dhe përdorimin e “Udhëzuesit për të evidentuar dhe luftuar marrëveshjet e ndaluara në prokurimet publike”.

Aspektet e advokacisë gjithmonë janë parë të lidhura ngushtë me aspektet e rritjes së **kulturës** së konkurrencës. Risia e vitit të kaluar ka qënë që pothuajse të gjitha rregulloret dhe udhëzuesit janë miratuar pasi kanë kaluar procesin e konsultimit publik duke u publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, si dhe sensibilizuar palët e interesit nëpërmjet njoftimeve për mediat të cilat kanë qënë koherente për të gjitha vendimet finale të Komisionit të Konkurrencës. Pjesë e tryezave konsultative me publikun nuk kanë qënë vetëm përfaqësuesit e biznesit, por edhe studiot ligjore si pjesë e sistemit të zbatimit me korrektësi të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjithashtu, institucioni i konkurrencës ka përdorur mundësitë e financimit të projektit të binjakëzimit IPA-2008, për të forcuar lidhjet me rrjetin akademik të universiteteve në Shkodër dhe Elbasan, si dhe me përfaqësuesit e pushtetit vendor të tyre.

Përgjatë kësaj periudhe kohore, Komisioni i Konkurrencës ka marrë 48 vendime: 7(shtatë) vendime për gjoba, nga të cilat 3 vendime me gjoba të rënda për praktika antikonkurruese dhe 4 vendime për gjoba të lehta për refuzim bashkëpunimi për realizimin e procedurave hetimore dhe mos njoftimin e përqendrimeve; 9(nëntë) vendime për autorizimin e kontrollit të përqendrimeve; 5 (pesë) vendime për dhënie rekomandimesh për institucionet publike dhe entet rregullatore në kuadër të advokacisë së konkurrencës (pa përfshirë opinionet e Komisionit të Konkurrencës të dhena jo në formë vendimi) ; 5 (pesë) vendime për bazën ligjore sekondare; vendimet e tjera janë procedurale (përfshirë vendimet për hapje hetimi paraprak, hapje hetimi të thelluar, etj).

Eficienca dhe ndikimi real në treg i vendimmarrjeve të Komisionit të Konkurrencës lidhen ngushtësisht me procesin e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, pasi pothuajse të gjitha vendimet që kanë konkluduar në shkelje të ligjit dhe që përmbajnë penalitete për ndërmarrjet, i janë nënshruar apelimit në gjykatë. Nëse i referohemi statistikave të cilat janë mjaft të detajuara në shtojcat e këtij raporti, në Gjykatën e Shkallës së Parë, janë apeluar gjithësej 26 vendime të Komisionit të Konkurrencës, nga të cilat 15 të fituara, 6 të humbura dhe 5 raste janë në proces. Ndërsa, në Gjykatën e Apelit, janë depozituar 21 raste dhe janë shqyrtuar 18 çështje, nga të cilat 11 janë fituar, 5 janë humbur dhe 2 janë në proces. Por, edhe në rastet kur Autoriteti ka fituar në Gjykatën e Apelit, ka vazhduar procesi nëpërmjet rekurseve në Gjykatën e Lartë (12 raste), ku prej tyre janë akoma në proces, 2 janë fituar dhe 1 rast është humbur<sup>1</sup>.

Por, përtej statistikave, shqetësimi kryesor i Komisionit të Konkurrencës është përthithja e filozofisë së konkurrencës nga gjyqësori pasi është shumë e rëndësishme arsyetimi bazuar në interesin publik të vendimeve të tyre. Prandaj, sfida kryesore e institucionit të konkurrencës ka qënë dhe është ndërtimi dhe konsolidimi i instrumentave të absorbimit të filozofisë së konkurrencës nga anëtarët e gjyqësorit të të gjitha niveleve. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2012 janë realizuar trajnime me gjyqëtarët në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe me ekspertët e projektit të binjakëzimit të financiar nga Bashkimi European. Gjithashtu, ky bashkëpunim është në vijim, pasi Shkolla e Magjistraturës ka përfshirë në programet e saj të trajnimit të drejtën shqiptare dhe europiane të konkurrencës.

Forcimin e kapaciteteve është konsideruar si instrumenti i rritjes së pavarësisë së institucionit të konkurrencës. Shtimi jo vetëm në numër, por edhe investimi duke përdorur buxhetin dhe financimin e Bashkimit European, janë rrugët e përdoruara për realizimin e këtij objekti edhe për vitin 2012. Struktura e institucionit miratuar nga Kuvendi në shkurt 2012, me shtesën prej 2 vete plotësoi jo vetëm nevojat e institucionit, por dhe kërkesën e progres raportit të BE për konkurrencën, ku theksohej rritja e kapaciteteve administrative. Gjatë vitit të kaluar i gjithë stafi i Autoritetit, nëpërmjet projektit të binjakëzimit, është trajnuar sipas programit të miratuar nga partnerët (gjithësej 118 ditë trajnimesh). Gjithashtu janë realizuar trajnime të fokusuara në përdorimin e analizat ekonometrike për trajtimin e praktikave antikonkurruese.

---

<sup>1</sup> AK vs Shogërive të Sigurimit – vendimi KK nr 50 datë 21.3.2007 “Vendosje gjome ndaj shogërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin e policës kufitare”. Dhoma e Këshillimit vendosi për mos kalionin e rastit në Kolegjin Civil.

Një pamje e detajuar i të gjithë aspekteve të përmendura më sipër paraqiten në vijim të këtij raporti vjetor. Pjesa e dytë fokusohet në momentet kryesore të procedurave që zbaton Autoriteti i Konkurrencës lidhur me trajtimin e ankesave dhe të praktikave sipas tre shtyllave kryesore të Ligjit: marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese, kontrollin e përqëndrimeve, monitorimin e tregut; rishikimin gjyqësor të vendimeve. Pjesa e tretë e raportit paraqet veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për rritjen e advokacisë dhe kulturës së konkurrencës, eksperiencat pozitive dhe jo shumë pozitive të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me palët e interesit. Bashkëpunimi me Komisionin European, me institucionet homologe dhe pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare të konkurrencës përshkruhen në pjesën e katërt. Veprimtaria e aktiviteteve mbështetëse në funksion të realizimit të objektivave të Autoritetit të Konkurrencës paraqitet në pjesën e pestë. Pjesa e fundit identifikon sfidat e së ardhmes dhe aspektet e veprimtarisë së institucionit të konkurrencës.

## **II. ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS**


Kjo pjesë fillon me një përshkrim statistikor të ankesave si fenomeni që po konsolidohet dhe që tregon shkallën e njohjes dhe të besimit të operatorëve të tregut apo të konsumatorit tek Autoriteti i Konkurrencës. Në vijim raporti fokusohet në paraqitjen e detajuar të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për zbulimin dhe penalizimin e praktikave antikonkurrese, të cilat shfaqen në formën e marrëveshjeve të ndaluara apo të veprimtarisë së bashkërenduar midis ndërmarrjeve, si dhe në formën e abuzimit me pozitën dominuese. Gjithashtu, kontrolli i përqëndrimeve përbën shtyllën e tretë të ligjit, zbatimi i të cilit është prezantuar në seksionin e katërt. Ndërsa eksperiencia e deritanishme e Autoritetit të Konkurrencës me shqyrtimet gjyqësore të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, të cilat përbëjnë një faktor të rëndësishëm për eficiencën e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës.

### **II.1 Administrimi i ankesave**

Rritja e nderhyrjeve të Autoritetit të Konkurrencës në treg ka sjellë rritjen e besimit të komunitetit të biznesit si dhe konsolidimin e profilit publik të Autoritetit të Konkurrencës. Një matës i drejtëpërdrejtë i kësaj performance është rritja në mënyrë të ndjeshme të numrit të ankesave të paraqitura gjatë vitit 2012 rreth 2 herë më shumë se një vit më parë. Gjatë vitit të kaluar janë depozituar 20 ankesa nga të cilat 14 ankesa kanë patur objekt në përputhje me ligjin kudrejt 6 rasteve të tilla të paraqitura në vitin 2011.

Klasifikimi i ankesave për vitin 2012 është bërë nisur nga objekti i ankesës dhe rezulton se janë paraqitur, 7 ankesa për marrëveshje të ndaluara apo sjellje të bashkërenduara, 5 ankesa për abuzimin me pozitën dominuese të një apo disa ndërmarrjeve 2 ankesa për rishikimin e akteve nënligjore të enteve rregullatore apo të institucioneve të tjera si dhe 6 ankesa që nuk ishin objekt i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Në vijim ankesat do të prezantohen sipas shtyllave të ligjit si dhe një paraqitje grafike e klasifikimit sipas objektit të ankesave të depozituar gjatë vitit 2012 jepet si më poshtë:



### ***II.1.1 Ankesa sipas objektit të ligjit:***

Në vijim ankesat për praktikant antikonkurrese do të prezantohen të grupuara sipas shtyllave kryesore të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, marrëveshjet e ndaluara apo sjellje të bashkërenduara, abuzimin me pozitën dominuese si dhe ankesat që adresojnë problematikat në mirë funksionimin e tregut të shkaktuara nga aktet ligjore apo nënligjore përkatëse.

#### ***Mbi marrëveshjet e ndaluara***

Ankesat e paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhen kryesisht me marrëveshje të dyshuara të ndaluara në tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Për vitin 2012 Autoriteti i Konkurrencës ka administruar shumë ankesa për karte të mundshme dhe më konkretisht:

#### ***Në tregun e ruajtjes dhe sigurisë fizike***

1. Ankesa e shoqërisë së ruajtjes dhe e sigurisë fizike (sh..r.s.f) “Trezhnjeva” Sh.p.k nëpërmjet së cilës kjo shoqëri shpreh shqetësimin e saj mbi sjelljen e

shoqërive sh.r.s.f, “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Nazëri – 2000” Sh.p.k, dhe “Dea Security” Sh.p.k, në prokurimet publike. Pas vlerësimit të ankesës u vendos hapja e procedurave hetimore në këtë treg duke hetuar sjelljen e këtyre ndërmarrjeve.

2. Ankesa e sh.r.s.f “Eurogjici Security” shpk lidhur me sjelljen e shoqërisë “Trezhnjeva” gjatë pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara kryesisht në Qarkun Kukës. Ne përfundim të procesit të vlerësimit dhe të shqyrtimit të asaj ankese nuk rezultuan fakte të arsyeshme për të vazhduar procedurat hetimore.
3. Ankesa mbi vendimin e pushimit të çështjes penale të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dërguar Autoriteti informonte mbi një çështje që gjykohej se ishte objekt i ligjit ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’. Informacioni i përcjellë nga prokurora shërbeu për të filluar një proces vlerësimi dhe grumbullim informacioni dhe shërbeu për të filluar procedurën hetimore në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korcës.
4. Ankesa e sh.r.s.f “Korca-Security” Sh.p.k mbi bashkëpunimin gjatë pjesëmarrjes në prokurimet publike në qytetin e Korçës të sh.r.s.f-ve: Vaso-Security; Security-Vaso; Alben 2 Security; E-Security. Objekti i kësaj ankese përputhej me objektin e informacionit të ardhur nga Prokuroria e Korçës.

#### Në fushën e transportit publik

5. Ankesa e shoqërisë “Alba-Trans” sh.p.k paraqitur sipas formularit të ankesës mbi shkeljen e konkurrencës në fushën e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës, pas vlerësimit të fakteve dhe monitorimit në tregun përkatës u vendos për hapjen e procedurave hetimore në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.
6. Ankesa e shoqërisë “GERARD-A” sh.p.k depozituar pranë Autoritetit adresonte të njëjtin shqetsim si ankesa e mësipërme, prandaj u bë pjesë e së njëjtës rasti hetimor.

#### Në sektorin ushqimor(vaji i luledielli)

7. Ankesa mbi rritjen dhe fiksimin e çmimit të vajit vegjetal nga disa ndërmarrje tregtuese të këtij produkti është dërguar nëpërmjet postës elektronike të Autoritetit të Konkurrencës, dhe pas vlerësimit dhe monitorimit të tregut u hapën procedurat hetimore.

### ***Mbi abuzimin me pozitën dominuese***

Ankesat lidhur me abuzimin e mundshëm me pozicionin dominues në treg janë kryesisht për sektorë të rregulluar ose sektorë ku një apo disa ndërmarrje zotërojnë pozicion dominues individual apo të përbashkët. Për vitin 2012 ankesat e administruara dhe të klasifikuara për pozitën dominuese janë si vijon:

#### **Në tregun e komunikimeve elektronike:**

1. Nga dy ankesa për abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese në tregun e telefonisë celulare, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë.
2. Ankesa e ndërmarrjes “Abissnet” sh.a, me objekt përcaktimin në mënyrë të njëanshme nga ndërmarrjet “Vodafone Albania” sh.a, “AMC” sh.a dhe “Albtelecom” sh.a të tarifës së re të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Bazuar tek shqetësimet e paraqitura u organizua një tryezë e përbashkët, në të cilën u diskutua mbi zhvillimet në treg dhe rregullimet që AKEP-i do të ndërmernte në treg.
3. Ankesa e ndërmarrjes “Premium-Albania” shpk ndaj ndërmarrjeve Albtelecom, Eagle Mobile, Vodafone dhe AMC, të cilat veprojnë në fushën e telefonisë, si tokësore, ashtu edhe në atë të lëvizshme. Nga shqyrtimi i ankesës, rezultoi se nuk ishte paraqitur asnjë provë apo fakt që të mundësonte gjykimin nëse ndodheshim në kushtet e cënimit të konkurrencës, prandaj ju kërkua ankuesit që të paraqitej pranë Autoritetit të Konkurrencës për të dhënë informacionin e domosdoshëm lidhur me ankesën. Por nuk kemi patur asnjelloj përgjigje nga operatori ankues.
4. Ankesa e ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a, drejtuar për dijeni edhe Autoritetit të Konkurrencës, adresohet kundër “Interpost” sh.p.k, lidhur me problemin e tarifave me shumicë dhe pakicë të aksesit të internetit. Nga vlerësimi i ankesës dhe i te dhenave mbi strukturën e tregut përkatës u konstatua se operatori INTERPOST sh.p.k ende nuk ka filluar veprimtarinë e vet, pra nuk ishim në kushtet e një firme me pozitë dominuese e cila mund të abuzonte me fuqinë e tregut.

#### **Në tregun e trasmetimeve televizive me pagesë**

1. Ankesë e ndërmarrjes “TV Kabllor XHACI”, kundër “TVM DEVOLLI” me pretendimin se i fundmi abuzon me çmimet e transmetimit kabllor. Autoriteti realizoi një monitorim për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit, shtrembërimit, apo pengimit të konkurrencës në tregun e ofrimit të shërbimit

të transmetimit kabllor në zonën gjeografike, Rrethi Devoll, Qarku Korçë. Nga ky monitorim nuk rezultoi të kishte abuzim me pozitën dominuese.

### ***Ankesa ndaj akteve ligjore apo nënligjore***

1. Ankesa e ndërmarrjes “IMPERIAL Claims Service - Albania”, lidhur me Rregulloren Nr. 129, datë 28.07.2012 “Për procedurën e miratimit të korrespondentit në Shqipëri” e miratuar nga Asambleja e anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS), e cila, (sipas ankuesit), kufizon dhe vendos barriera artificiale për operatorët e tjerë që duan të punojnë në tregun e dëmeve të “kartonit jeshil” (siguracion ndërkombëtar), si dhe me anë të kësaj Rregulloreje BSHS merr funksionin e entit mbikëqyrës dhe rregullator për funksionimin e këtij nëntregu brenda tregut të sigurimeve, kur organi i tillë i vetëm ligjor i tregut është AMF-ja. Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë BSHS-së një amendim në nenin 3 të Rregullores “Për procedurën e miratimit të korrespondentit në Shqipëri”.
2. Ankesa e ndërmarrjes “Sigal UG Austria” sh.a. ndaj vendimit 142 dhe 151, datë 29.10.2012 të bordit të AMF. Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 254 datë 06.12.2012 vendosi t’i rekomandojë AMF-së kryerjen e disa revokimeve në Rregulloren “Për caktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, (të ndryshuar) dhe në Vendimin Nr. 151, datë 29.10.2012 të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike mbi sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”.

### ***II.1.2 Ankesa jashtë objektit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”***

Pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur ankesa të cilat edhe pse nuk përbënin objekt trajtimi në zbatim të Lligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë marrë në konsideratë për të evidentuar problematikën reale që përcillej nëpërmjet tyre duke identifikuar institucionin përgjegjës, të cilit i përcillej ankesa respektive. Ky qëndrimi proaktiv i institucionit të konkurrencës është konsideruar si një instrument për të rritur besimin e komunitetit të biznesit. Në mënyrë të përmbledhur në vijim paraqiten ankesat e depozituara gjatë vitit 2012, pranë Autoritetit, objekti i të cilave nuk përputhej me ligjin bazë të konkurrencës.

1. Kërkesa e Shoqërisë “Elka S.A” Sh.A me nr. 357 prot., dt.14.05.2012, nëpërmjet së cilës kjo shoqëri shpreh shqetësimin lidhur me kopjimin, që

shoqëria “Olimbia Gaz” i ka bërë markës së mallit të saj në kundërshtim me ligjshmërinë, markë i cila është certifikuar dhe mbrojtur nga DPPM. Nga shqyrtimi i kërkesës rezultoi se problematika e ngritur në të konsistente në shkeljen e të drejtave të pronësisë industriale, mbrojtja e të cilave qe objekt i Ligjit Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, prandaj iu dërgua për kompetencë Drejtorisë së Përgjithëshme të Markave dhe Patentave.

2. Ankesa e shoqërisë “OLIM” sh.a mbi nxjerrjen në mënyrë të përsëritur në treg nga shoqëria Crystal të mallrave që nuk përmbushin standardet e cilësisë, sasisë dhe parametra të tjerë. Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se problemi i ngritur nga ndërmarrja Olim kundrejt ndërmarrjes Crystal nuk konsiston në një sjellje antikonkurruese sipas ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke dalë në këtë mënyrë jashtë kompetencës së Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ankesat e shoqërisë “Marketing & Distribution”; grupit të operatorve ekonomikë (Mond Office; Interas Group; Marketing & Distribution; Cartoshop; Sinteza; BNT; New Office Albania); lidhur me kërkesat që nuk konsiderohen të domosdoshme për kualifikim në procedurat e prokurimit publik. Pas realizimit të procedurave për shqyrtimin e ankesave, rezultoi se ankesa e bashkimit të operatorëve “Marketing & Distribution” i është nënshtruar shqyrtimin administrativ nga organi kompetent, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në legjislacionin e prokurimeve publike duke kaluar nëpër të gjitha fazat administrative të përcaktuara në ligjin specifik të prokurimeve.
4. Shtëpia botuese Alb-Juris, depozitoi një ankesë ndaj Qendrës së Publikimeve Zyrtare (QPZ), duke pretenduar se çmimi i botimeve të QPZ-së nuk pasqyron koston reale të botimeve juridike (kjo kosto është e vendosur me udhëzim të Ministrisë së Financave ku përcaktohet një çmim 2 lek/fleta) gjithashtu në çmimin e publikimeve të QPZ-së nuk llogaritet as kostoja e kapakut dhe e procesit parapërgatitor, duke bërë që ajo Qendër të jetë pa efikasitet ekonomik. Kjo ka sjellë që tregtuesit e librave (kryesisht Libri Universitar) të blejnë gjithë sasinë e botimeve për shkak të çmimit të ulët për t'i shitur ato më pas me çmime të larta. Si përfundim, nga vlerësimi i ankesës rezultoi se nuk ishim para rastit të abuzimit të mundshëm më pozitiv dominues dhe për pasojë ankesa ishte jashtë objektit të Ligjit.
5. Ankesa e një qytetari nga Korça nëpërmjet së cilës ankuesi parashtroi përpara Autoritetit të Konkurrencës shqetësimin lidhur me veprimtarinë ekonomike të një shitësi ambulant në qytetin e Korçës, në kundërshtim me legjislacionin tatimor. Pas shqyrtimit të ankesës u çmua se problematika e ngritur në të nuk lidhej me shkelje të ligjit dhe shqyrtimi i saj ishte jashtë objektit të ligjit “Për



mbrojtjen e konkurrencës”. Megjithë atë ky shqetësim iu dërgua për trajtim Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për plotësimin e standarteve të tregëtimit.

6. Ankesa e Shoqërisë “AMC” sh.a ndaj shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, lidhur me reklamën e kësaj te fundit mbi ofrimin e shërbimit të internetit 3G. Pas vlerësimit të saj u konkludua se ajo ishte jashtë objektit të Ligjit nr. 9121, datë 23.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
7. Komete në lidhje me Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve të Interkoneksioneve të dërguara për mendim nga Shoqata Shqiptare e furnizuesve të Energjisë Elektrike. Në lidhje me to, u konstatua se komentet janë thjesht të karakterit teknik dhe se nuk përbënin ndonjë shkelje objekt i Ligjit.

Sikurse u prezantua në këtë seksion, bazuar në ankesat e depozituara gjatë viti të kaluar janë hapur 5 raste hetimore, si dhe janë realizuar disa monitorime, si dhe janë gjeneruar disa rekomandime për entet rregullatore, apo institucionet e qeverisë qendrore dhe lokale.

Në vijim do të paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha rastet hetimore të realizuara gjatë vitit 2012 të grupuar sipas dy shtyllave kryesore të ligjit: marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimi me pozitën dominuese.

## **II.2. Marrëveshjet e ndaluara (kartelet)**

Evidentimi dhe parandalimi i marrëveshjeve të ndaluara që kanë si objekt ose pasojë kufizime të rënda të konkurrencës në treg ka qenë një ndër prioritetet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2012. Tashmë është e pranuar gjerësisht që kartelet mbajnë çmime më të larta se ekuilibri i tregut dhe për pasojë dëmtojnë mirëqenien sociale, krijojnë inefficienca ekonomike dhe transferojnë mirëqenien nga konsumatorët tek pjesëmarrësit në marrëveshje.

Gjatë vitit 2012 Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar disa procedura hetimore me synimin e zbulimit të marrëveshjeve apo të praktikave të koordinuara midis operatorëve në disa tregje, të cilat janë në vijim:

### ***II.2.1 Hetimi në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL)***

Autoritetit të Konkurrencës, duke marrë shkas nga prononcimet në median e shkruar dhe televizive, në fillim të muajit shkurt të vitit të kaluar, mbi rritjen në të

njëjtën kohë të çmimeve të sigurimit të mjeteve motorrike, realizoi në mënyrë të menjëhershme një monitorim të çmimeve në treg. Nga monitorimi u konstatua se kompanitë e sigurimit, kishin rritur në mënyrë të menjëhershme dhe në të njejtin nivel çmimet e primet e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta që prej datës 1 Shkurt 2012. Bazuar në të dhënat e monitorimit, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 215, datë 10.02.2012 u shpreh për hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL), për të identifikuar shenjat e kufizimit potencial të konkurrencës në tregun përkatës. Në vijim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në gjetjet e raportit të hetimit paraprak mbi ekzistencën e shënjave të kufizimit të konkurrencës në formën e marrëveshjes për fiksimit të primit të shitjes së MTPL-së, u shpreh me vendimin nr. 222, datë 11. 04. 2012, për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL).

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në evidencat e grumbulluara gjatë procedurës hetimore dhe të pasqyruara në raportin e hetimit të thelluar të hartuar nga Sekretariati, si dhe pas dëgjimit të palëve në seancë dëgjimore, u shpreh me vendimin nr 246, datë 09.10.2012. Në këtë vendim u argumentua se ndërmarrjet aktive në tregun e sigurimeve kishin kufizuar konkurrencën nëpërmjet fiksimit të primeve të sigurimit për produktin MTPL-se dhe vendosi gjatë hetimit të thelluar të sigurimeve me një gjatësi të vlerës totale 88,9 milion lekë.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës bazuar në gjetjet e raportit të hetimit të thelluar realizuar nga grupi i punës, organizoi një tryezë të rrumbullakët me përfaqësuesit e AMF-së, në të cilën u diskutua mbi problemet e evidentuar gjatë hetimit në tregun e sigurimeve të MTPL-së. Në përfundim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 247, datë 09.10.2012, “Për rekomandime Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL)”. Këto rekomandime konsistojnë në ndryshimin e pikës 3, të nenit 9 të Rregullores nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, duke ulur afatin minimal për ndryshimin e primit të sigurimit, (ii) implementimin në një kohë sa më të afërt të sistemit bonus-malus, i cili do të krijonte mundësi për një diversitet dhe aplikim të primeve të ndryshme për çdo policë siguri të detyrueshëm motorrik, duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis kompanive që operojnë në këtë treg si dhe (iii) të shmangët bashkëveprimi i aktuarëve të kompanive të sigurimit me njëri tjetrin në procesin e përlogaritjeve të primeve të rrezikut dhe ky proces të realizohet nga AMF mbështetur në të dhënat e siguruar në mënyrë të pavarur nga shoqëritë e sigurimit.

Gjatë procesit të inspektimeve të hetimit paraprak, një nga ndërmarrjet nën hetim nuk lejoi kryerjen e inspektimeve të befasishme siç parashikon ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në këtë rast Autoriteti i Konkurrencës bashkëpunoi ngushtësisht me Policinë e Shtetit. Bazuar në ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 216, date 01.03.2012, vendosi gjobë për shkelje të lehta ndaj ndërmarrjes “Intersig” sh.a për pengim në realizimit e inspektimit nga inspektorët e Autoritetit. Vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës për këtë kundërvajtje administrative u realizua pas kryerjes së seancës dëgjimore me shoqërinë “Intersig” sh.a, procedure kjo e realizuar sipas nenit 39 të Ligjit Nr.9121, date 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar). Vendimi i Komisionit të Konkurrencës për këtë rast u konfirmua edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila la në fuqi vendimin e Komisionit.

### ***II.2.2 Hetimi thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike***

Sikurse është raportuar në vitin e kaluar, bazuar në një ankesë, Komisioni i Konkurrencës në fund të muajit Dhjetor 2011 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

Në përfundim të hetimit paraprak rezultoi se në dokumentat e ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e tenderave publik kishte shenja të bashkëpunimit, të cilat mund të përbënin kufizim të konkurrencës në kuptim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Komisioni i Konkurrencës duke marrë në konsideratë rrezikun e kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit, me vendimin nr. 220, datë 16.03.2012 vendosi: marrjen e masave të përkohshme për ndërmarrjet, që t’i japin fund bashkëpunimit mes tyre gjatë procedurave të prokurimeve publike në tregun e shërbimeve të rojeve fizike, si dhe i detyron këto ndërmarrje të sillen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë procedurave të prokurimeve publike sa i përket caktimit të ofertës dhe/ose ndarjes së tregut përkatës. Gjithashtu u hap hetimi thelluar në këtë treg.

Bazuar në gjetjet e hetimit paraprak, të paraqitura në raportin e hetimit, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 219, datë 16.03.2012, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k. Sipas evidencave të administruara gjatë inspektimeve të befasishme (down raids) rezultoi se në dokumentet e paraqitura në procedurat e tenderëve publike nga këto ndërmarrje, kishte shenja të bashkëpunimit të cilat

tregojnë që përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët, të cilët kanë punuar ngushtësisht me njëri-tjetrin. Metodologjia që përdoret gjatë hetimit është metodologjia që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike, e cila është kthyer në një udhëzues për luftën ndaj marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike. Ky udhëzues jep format e marrëveshjes së ndaluar midis ofertuesve, mënyrat se si ofruesit bien dakord të eliminojnë konkurrencën, listimin e karakteristikat që ndihmojnë marrëveshjen, reduktimin e koordinimit të sjelljes në procesin e prokurimeve, risku i tenderimeve me marrëveshje, ndërgjegjësimin e stafit të prokurimeve për ofertat me marrëveshje, etj.

Në vijim të procedurave, pas përfundimit të raportit të hetimit të thelluar, Komisioni i Konkurrencës, organizoi seancën dëgjimore më palët objekt hetimi duke u krijuar mundësinë e njohjes me raportin e hetimit të thelluar dhe me dosjen hetimore, si dhe mundësinë e paraqitjes së pretendimeve të tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale para Komisionit.

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në gjetjet e paraqitura në raportin e hetimit të thelluar të hartuar nga Sekretariati, të cilat vërtetojnë ekzistencën e një marrëveshje në oferta (bid rigging) në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Nazëri – 2000”, dhe “Dea Security” sjellje të cilat bien në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), të Ligjit nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, si dhe pas dëgjimit të palëve, vendosi gjëbotjen e pjesëmarrësve në marrëveshje me shumën totale 2,5 milion lekë në vendimin nr. 240, date 26.7.2012.

Gjithashtu, iu rekomandua Agjensisë së Prokurimit Publik moslejimi i nënkontraktimit midis ofertuesve të të njëjtit tender, pasi kufizon mundësinë e ofertimit në mënyrë të pavarur si dhe të atyre kontratave të cilat për nga natyra specifike e tyre, duhet të kryhen nga vetë kontraktuesi si dhe publikimin e të gjitha dokumenteve (kryesisht: formularin e plote të njoftimit të fituesit dhe formularin e plotë të nënshkrimit të kontratës së lidhur) lidhur me këto procedura prokurimi dhe mundësinë e ruajtjes së tyre në faqen zyrtare elektronike të APP-së, në vite, me qëllim rritjen e transparencës.

### ***II.2.3 Hetimi në tregun e importit, prodhimit dhe tregimit me shumicë të vajit të lulediellit***

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të një ankese mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal në treg, ka monitoruar tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

Rezultatet e monitorimit si: shkalla e lartë e përqëndrimit në tregun e importit dhe prodhimit të vajit; rritja e çmimit të vajit vegjetal është reflektuar në tregun e shitjes me pakicë; çmimet e shitjes me shumicë nuk kanë reflektuar në kohë zbritjet dhe kanë reaguar menjeherë ndaj rritjes së çmimeve të blerjes në tregjet ndërkombëtare, ishin argumentat bazë të vendimit nr. 245, datë 02.10.2012 të Komisioni i Konkurrencës. Ky vendim hapi procedurën e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, për të parë nëse ka kufizime të konkurrencës në këtë treg.

Në vazhdim të procedurave, Sekretariati realizoi inspektive të befasishme (Down Raids) në të njëjtën kohë në të gjitha ndërmarrjet që përmendeshin në ankesën e ardhur Auroritetit të Konkurrencës. Për analizën e konkurrencës në tregun përkatës, Sekretariati ka kërkuar informacion nga këto ndërmarrje dhe ka bashkëpunuar me institucionet publike si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe INSTAT. Analiza e kufizimit të mundshëm të konkurrencës në tregjet përkatëse është mbështetur në dy shtyllat kryesore që përcakton Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, marrëveshjet potenciale të ndaluara dhe abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese.

Në përfundim të procedurave hetimore, duke vlerësuar pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, rrjetin e shpërndarjes dhe konkurrencën potenciale, asnjë nga ndërmarrjet nuk përmbushte kriteret e nenit 8, duke mos zotëruar pozitë dominuese në tregun e shitjes me shumicë. Për të vlerësuar nëse rritja e çmimeve ka ardhur si rezultat i koordinimit të sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun e shitjes me shumicë, Sekretariati ka analizuar sjelljen e ndërmarrjeve lidhur me vendosjen direkte dhe indirekte të çmimeve, kufizimin e ofertës, ritmet dhe masen e ndryshimit të çmimeve mesatare të shitjes me shumicë në raport me çmimet e blerjes në tregun ndërkombëtar, ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit, nga ku rezultoi se konkurrentët kryesorë me pjesë tregu të përafërt kanë aplikuar çmime të shitjes me shumicë të cilat, nuk reflektojnë me çmimet në tregun ndërkombëtar në rastet kur ka ulje të çmimit në tregun ndërkombëtar; konvergojnë në trendet e rritjes së çmimit për periudhën objekt hetimi shenja këto që tregojnë se mund të ketë një sjellje të bashkërenduar të këtyre ndërmarrjeve, e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

Komisioni i Konkurrencës bazuar në gjetjet e raportit të hetimit paraprak hartuar nga Sekretariati, me vendimin nr 249, datë 09.11.2012 vendosi hapjen e

procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit” ndaj ndërmarrjeve Erbiron, Olim dhe Crystal.

Sekretariati ka realizuar procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodin e Procedurave dhe Rregulloren e Procedurave Investigative. Në përfundim të procedurave, do te paraqesë pranë Komisionit të Konkurrencës raportin, ku është analizuar sjellja e ndërmarrjeve nën hetim.

#### ***II.2.4 Hetimi i thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe me thasë***

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të informacioneve se në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos dyshohej për një marrëveshje të fshehtë për rritjen e çmimit, ka monitoruar tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit çimento.

Bazuar në gjetjet gjatë monitorimit, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr 233, datë 16.07.2012, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos. Pas njohjes së gjetjeve të hetimit paraprak, ku u evidentuan shenjat e kufizimit të konkurrencës për produktin çimento të tipit 42.5 rifuxho dhe me thasë si shkallë shumë e lartë përqendrimi në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë, barriera në hyrje, tendencë e fortë e rritjes së çmimit në një periudhë të caktuar, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr 253, datë 03.12.2012, u shpreh për hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg ndaj ndërmarrjeve prodhuese dhe importuese të çimentos.

Sekretariati po realizon procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodin e Procedurave dhe Rregulloren e Procedurave Investigative. Në përfundim të procedurave do te paraqesë pranë Komisionit të Konkurrencës raportin, ku do të analizohet sjellja e ndërmarrjeve nën hetim.

#### ***II.2.5 Hetim paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.***

Shkak për nisjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike u bë ankesa e një shoqërie, e cila bën me dije se ndërmarrjet kanë përdorur skema të bashkëpunimit midis ofertuesve, në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, të cilat mundësojnë ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar në prokurimin e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës është njohur edhe me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi vetë Prokuroria e këtij rrethi, me anë të shkresës nr 2926 prot E.S, datë 19.07.2012, ka paraqitur pranë Autoritetit të

Konkurrencës vendimin e datës 17.07.2012 për pushimin e çështjes penale nr. 466 të vitit 2012. Me anë të kësaj shkrese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, shpjegon se pasi ka vlerësuar faktet e paraqitura gjatë procedimit penal, është e mendimit se subjektet “Hoxha Security”, “Nisa Security” dhe “Korça Security” kanë bërë një marrëveshje paraprake, e cila dëmton konkurrencën e lirë.

Duke qënë së në përfundimin të hetimit paraprak rezultoi se në dokumentat e ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e prokurimit publik ka shenja të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve, sjellje të cilat bien në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr 257, datë 13.12.2012 vendosi hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës .

Sekretariati po realizon procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodin e Procedurave dhe Rregulloren e Procedurave Investigative. Në përfundim të procedurave, do të paraqesë pranë Komisionit të Konkurrencës raportin, ku do të analizohet sjellja e ndërmarrjeve nën hetim.

#### ***II.2.6 Hetimi paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.***

Pas shqyrtimit të ankesës së ndërmarrjes “Alba Trans” , e cila përmban shenja për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 252, datë 26.11.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

Bazuar në evidencat e grumbulluara gjatë inspektimeve të realizuara në hetimit paraprak, rezultoi se janë evidentuar disa elementë të kufizimit të konkurrencës në tregun e tregtimit së biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe të studentit në shërbimin e transportit të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, të cilat mund të përbëjnë shkelje të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr 262, datë 14.01.2013, vendosi hapjen e hetimit të thelluar në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas në qytetin e Tiranës ndaj ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.

Sekretariati po realizon procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodin e Procedurave dhe Rregulloren e Procedurave

Investigative. Në përfundim të procedurave, do të paraqesë pranë Komisionit të Konkurrencës raportin, ku do të analizohet sjellja e ndërmarrjeve nën hetim.

### ***II.2.7 Hetimi paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës***

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.218, date 23.02.2012, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës. Ky vendim erdhi si rezultat i monitorimit të këtij tregu duke marrë shkas nga një letër e botuar në media, në emër të dy shoqërive të shërbimeve portuale në Portin e Vlorës, (Alpida sh.p.k dhe Delfini 1 sh.p.k) të cilat sipas kësaj deklarate kane ndërprerë shërbimin duke aplikuar një grafik udhëtimi të përbashkët, duke operuar një ditë njeri traget dhe një ditë tjetri si dhe çmime tepër të larta për linjën Vlore-Brindisi-Vlore.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.232, date 16.07.2012, vendosi zgjatjen e afatit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, pasi në tregun përkatës gjatë periudhës hetimore kanë ndodhur ndryshime, ku struktura e tregut ndryshoi nga duopol në monopol, si dhe ardhja e sezonit të verës ("peak") e gjen tregun përkatës me një operator të vetëm në kushtet kur kërkesa ka rritje të fortë dhe fuqia kundërvepruese e blerësve në tregun përkatës është e ulët.

Gjatë procedurave të hetimit paraprak është bashkëpunuar edhe me MPPT dhe Autoritetin Portual Vlorë ku është stabilizuar situata nëpërmjet ndërhyrjes dhe kontratave dypalëshe.

Komisioni i Konkurrencës në përfundim të procedurave hetimore, bazuar në sjelljet e ndërmarrjeve në tregun përkatës me vendimin nr 248, datë 11.10.2012, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës", pasi nuk u provua se ka shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës sa i përket abuzimit me pozitën dominuese, apo marrëveshjeve të ndaluara në tregun përkatës.

## **II.3 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve**



### ***II.3.1 Perjashtim nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive në tregun e sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin e policës kufitare të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta***

Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 5 dhe 48 të Ligjit ka marrë kërkesën nga shoqëritë e sigurimeve për përjashtim nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit në tregun e sigurimeve të mjeteve motorrike (Polica Kufitare). Kjo marrëveshje konsiston në shkëmbimin e informacionit për llogarritjen e dëmit, studimet e tregut dhe mbulimin e përbashkët të risqeve që rrjedhin nga mbajtësit e policës kufitare të sigurimit. Me marrjen e informacionit të plotë është publikuar një njoftim paraprak për shtyp në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës për shprehjen e interesit nga palët e treta. Gjatë periudhës 15-ditore të publikimit nuk ka patur asnjë reagim nga palë të treta në adresat e publikuara të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës në gjykimin e këtij rasti i është referuar edhe rregullores së Komisionit Europian 267/2010 “Mbi aplikimin e nenit 101 (3) të TFEU”, e cila parashikon përjashtimin nga ndalimi të një sere kategorish marrëveshjesh, vendimesh dhe praktikave në sektorin e sigurimeve kur në mungesë të databaseve të sakta palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit lidhur me: përcaktimin e provigjoneve të përbashkëta për riskun; vendosjen e standardeve të përbashkëta të policës së sigurimit si dhe mbulimin e përbashkët të disa llojeve të riskut dhe produkte të tjera.

Marrëveshja e bashkëpunimit është një marrëveshje horizontale standartizimi e cila ka si mision rritjen e standarteve të emetimit dhe tregëtimit të policës kufitare të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike, përcaktimin e kërkesave teknike dhe cilësore me të cilat do të përputhet produkti i policës kufitare, eliminimin e produkteve të falsifikuara apo të shitjeve në rrugë si dhe rritjen e përgjegjshmërisë së palëve për përballimin e dëmeve nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mes palëve.

Pas analizës së aplikimit, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr 225 datë 28.05.2012 vendosi përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit për ofrimin e shërbimit të policës kufitare të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, midis shoqërive të sigurimit vetëm me respektimin e disa kushteve dhe detyrimeve, të cilat lidhen me riformulimin e pjesëve të marrëveshjes si dhe me

shkurtimin e afatit të përjashtimit nga 5 (pesë) në 3 (tre) vjet dhe saktësimin e dy shprehjeve bazuar në rregulloren respektive të BE-se.

## **II.4 Abuzimi me pozitën dominuese**

Në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës , vlerëson fuqinë në treg të operatorëve si dhe penalizon operatorët që kanë abuzuar me këtë fuqi tregu në formën e vendosjes në mënyrë të drejtëpërdrejtë të çmimeve apo kushteve të padrejta; kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimin teknik; zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregëtare të njëjta apo vendosja e kushteve apo detyrime shtesë për lidhjen e kontratave me palët e tjera

### ***II.4.1 Hetimi i thelluar në tregun e shërbimit, ngarkim- shkarkimit të GLN në Porto Romano***

Sikurse është raportuar vitin e kaluar gjatë vitit 2011, Autoriteti i Konkurrencës, bazuar nga ankesat e dy ndërmarrjeve që operonin në tregun e importit dhe tregëtimin me shumicë të GLN-së, kishte realizuar procedurat hetimore në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në Porto Romano. Gjatë procedurave hetimore është konstatuar se në muajin gusht 2011, ndërmarrja “Romano Port” SHA ka kushtëzuar shkarkimin e anijeve me GNL me nënshkrimin e një kontrate tip, e cila i ngarkon me detyrime të tjera shtesë operatorët ekonomikë që duan të shkarkojnë produktet e tyre në depozitat që kanë ndërtuar në zonën bregdetare. Marrëveshja koncesionare si dhe rregullorja për funksionimin e portit, parashikojnë se çdo operator ekonomik i licencuar, (nenit 36 pika f dhe neni 37) ka të drejtë të shkarkojë mallin e tij dhe koncensionari “Romano Port” sha duhet të plotësojë kërkesën e operatorit ekonomik. Ky detyrim për ndërmarrjen objekt hetimi rrjedh nga aktet ligjore dhe nënligjore dhe kushtëzimi i ofrimit të shërbimit me kërkesa shtesë është i pambështetur dhe i pabazuar në ligj.

Pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar për gatitur nga ana e grupit të punës dhe dëgjimit të pretendimeve të operatorit objekt hetimi në seancë dëgjimore, pretendime të cilat u depozituan edhe me shkrim, Komisioni I Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 221, datë 11.04.2012 “Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare”. Komisioni i Konkurrencës ka konstatuar se ndërmarrja “Romano Port” sha zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare gjatë periudhës objekt hetimi. Ky operator në mënyrë të përsëritur ka refuzuar të realizojë procesin e shkarkimit të GLN-së për operatorët që kanë investuar për kapacitet depozituese në pronësi të tyre duke paraqitur arsye të paligjshme dhe të paarsyeshme. Ky refuzim lidhet me interesat ekonomike të drejtëpërdrejta të këtij operatori në tregjet e rrjedhës së poshtme pra,

atë të depozitimit dhe të tregëtimit me shumicë të GLN-së, duke sjellë kufizimin e konkurrencës në këto tregje.

Komisioni i Konkurrencës ka vendosur gjithashtu gjobitjen për këtë shkelje të rëndë të ndërmarrjes “Romano Port” sha në masën 2.35% të xhiros totale të kësaj ndërmarrje për vitin 2010 që korrespondon me shumën 6,7 milion lekë si edhe urdhërimin e “Romano Port” sha të mos kushtëzojë ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit duke krijuar pengesa me sjelljen e saj ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e depozitimit dhe të importit e tregëtimit me shumicë të GLN-së.

#### ***II.4.2 Hetimi paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë***

Procedurat e hetimit paraprak në tregun e telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë kanë nisur që në vitin 2011. Nga të dhënat e siguruar rezultojnë se në rrjedhën e poshtme të tregut me pakicë të kartave me parapagesë në telefoninë fikse ka konkurrencë pasi janë disa operatore që ofrojnë këtë shërbim në këtë nivel tregu. Gjithashtu, nga analiza e tregut vihet re se çmimi i shitjes së produktit me anë të kartës Alblue të Albtelecom është i përafërt me koston minimale të nevojshme që operatorët e shërbimit të kartave të parapaguara duhet të paguajnë për realizimin e një thirrje të suksesshme.

Pas shqyrtimit të këtij raporti, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur mbylljen e hetimit paraprak në këtë treg pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 9121 , datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Gjithashtu me anë të vendimit nr.231, datë 05/07/2012, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur që t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare që të vendosë detyrimin për ndërmarrjen Albtelekom që gjithë shërbimet apo produktet që Albtelekom ofron për konsumatorin të pasqyrohen apo të mbahen në llogari financiare të veçanta, duke përfshirë edhe kartën me parapagesë në telefoninë fikse ALBLUE. Kjo do të krijojë kushte që shërbimet apo produktet të kenë transparencë në përcaktimin e kostove, si dhe do të parandalojë fenomenet antikonkurruese që mund të jenë pasojë e kostove joreale.

#### ***II.4.3 Hetimi paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë***

Pas ankesave të ardhura pranë Autoritetit të Konkurrencës nga operatorë të tregut të telefonisë celulare, si edhe realizimit të një monitorimi në tregun e telefonisë celulare me pakicë, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me anë të vendimit nr.258 , datë 21.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë’.

Sekretariati po realizon procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, “Kodin e procedurave” dhe ‘Rregulloren e procedurave investigative’. Në përfundim të procedurave, do të paraqesë pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit paraprak, ku do të evidentohet nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun objekt hetimi.

## **II.5. Kontrolli i përqëndrimeve**

Kontrolli i përqëndrimeve përbën shtyllën e tretë të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nëpërmjet të cilit realizohet mbikqyrja e ndryshimit të strukturave të tregjeve nga institucioni i konkurrencës. Për të rritur eficiencën e zbatimit të ligjit, edhe gjatë vitit 2012 janë realizuar mbikqyrje të transaksioneve të realizuara dhe të pasqyruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Bazuar në bashkepunimin e ngushtë me QKR, Autoriteti i Konkurrencës ka mundur të evidentimin e transaksioneve të shit/blerjeve të aksioneve, të cilat nuk ishin njoftuar, pra ndërmarrjet e përfshira në këto transaksione nuk kishin realizuar detyrimin ligjor të njoftimit. Gjatë vitit të kaluar janë realizuar 4 raste të ushtrimit të kontrollit të transaksioneve të shit/blerje të aksioneve me iniciativën e Autoritetit të Konkurrencës, dhe në këto, 2 raste ishin përqëndrime me ndryshim kontrolli. Ndërmarrjet që kishin përfituar kontrollin dhe kishin shkelur ligjin duke mos njoftuar brenda një muaji, janë penalizuar me gjoba të lehta (3 raste mosnjoftimi në kohë të transaksioneve).

### **II.5.1 Përqëndrimet e autorizuar**

Gjatë vitit 2011, janë shqyrtuar dhe autorizuar 9 praktika përqëndrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar në treg, ashtu edhe për efektet pozitive të pritshme për të sjell në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg.

#### **i. Bashkim i dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra**

Nga përqëndrimet e autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, gjatë vitit 2012, asnjë rast nuk ka rezultuar të jetë bashkim apo shkrirje i/e dy ndërmarrjeve.

#### **ii. Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të kësaj të fundit**

Në tregun e veprimtarisë së ndërtimit, është realizuar përqendrimi nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga ndërmarrjet Euronuovo Sh.p.k dhe Euroteorema Sh.p.k të ndërmarrjen Euro Investment Group Sh.p.k. Përqendrimi është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr.213, datë 24.01.2012 dhe ka rezultuar se nuk krijonte apo forconte pozitën dominuese të ndërmarrjeve Euronuovo dhe Euroteorema në tregun përkatës të produktit.

Në tregun e lojrave të fatit, është shqyrtuar përqendrimi i realizuar në ndërmarrjen “Bet 07” Sh.a, i cili u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 214, datë 24.01. 2012. Përqendrimi nuk ndryshonte strukturën e përgjithshme të tregut të lojrave të fatit në Shqipëri, pasi ai lidhej vetëm me ndryshimin e strukturës së zotërimit të aksioneve brenda shoqërisë “Bet 07”. Përqendrimi i realizuar nuk shfaqte shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të shoqërisë “Bet 07” Sha.

Në tregun e motorçikletave, është shqyrtuar përqendrimi nëpërmjet përfutimit të 100 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Audi Aktiengesellschaft tek shoqëria Ducati Motor Holdings S.p.A. Ky transaksion u autorizua me Vendim 227, datë 28.06.2012, pasi ky transaksion nuk ka sjellë asnjë mbivendosje të aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në nivel horizontal dhe as ka rezultuar të ketë pasur tregje të prekura dhe nuk ka pasur ndonjë ndikim në tregun e brendshëm.

Në tregun e hoteleri turizmit, është autorizuar përqendrimi e realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k me Vendimin Nr. 228, datë 28.06. 2012 të Komisionit të Konkurrencës. Pozicioni në treg i pronarit të ri të Tirana International Hotel & Conference Center nuk ka ndryshuar edhe pas përqendrimit, pra transaksioni nuk ka rezultuar të shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti dhe për këtë arsye është autorizuar.

Në tregun e veprimtarisë radio – televizive, është autorizuar përqendrimi i ndodhur, i cili ka si pasojë zvogëlimin të numrit të aksionerëve në ndërmarrjen Media Vizion Sh.A, me vendim nr. 237, datë 26.07. 2012. Përqendrimin me objekt përfutimin nëpërmjet dy transaksione sipas të cilave shoqëritë Ost Holding GmbH dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku ka rezultuar se nuk ka shfaqur shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese pasi ky transaksion ka sjellë ndryshimin kontrollit në shoqërinë Media Vizion sh.a.

Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të plotë të kontrollit të shoqërinë V.D.M Invest Comm. VA, nëpërmjet blerjes së 99.99% të aksioneve nga shoqëria Japan Tobacco International Holding B.V. u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 238, datë 26.07. 2012, pasi transaksioni nuk kishte asnjë efekt në tregun shqiptar të cigareve të përpunuara dhe të prodhuara dhe nuk sillte krijim apo forcim të pozitës dominuese në tregun e brendshëm për ndërmarrjet objekt përqendrimi.

Në tregun e prodhimit të çokollatave, është realizuar përqendrimi nga ndërmarrja e njohur Ferrero. Ky përqendrim u autorizua me Vendim nr. 244, datë 20.09. 2012 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit 100 % nga shoqëria Ferrero International S.A të Business NAT dhe të 49% të Bussines SL (të zotëruara nga Grupi Stelliferi)” pasi ka rezultuar se ky transaksion nuk ka shfaqur shqetësime për konkurrencën në tregun e brendshëm.

Në sektorin bankar gjatë vitit 2012, janë realizuar dy përqendrime, të cilat kanë pasur të bëjnë me bankat Greke, prezente në Shqipëri me anë të filialeve të tyre. Konkretisht: përfutimin e kontrollit të të Eurobank Ergasias S.A nga National Bank of Greece S.A dhe të Emporiki Bank of Greece S.A nga Alpha Bank S.A të autorizuar përkatesisht me Vendimet nr.255, datë 11.12. 2012 dhe nr. 259, datë 27.12. 2012. Në të dyja rastet përqendrimet kanë rezultuar se nuk kanë shkaktuar efekte në strukturën e tregut bankar në Shqipëri, pra nuk krijonin apo forconin pozitën dominuese në tregun përkates.

### **iii. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, që kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur – (Joint Venture)**

Nga përqendrimet e autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, gjatë vitit 2012, nuk rezultoi asnjë ndryshim të qëndrueshëm kontrolli që vinte si pasojë e krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët (*joint venture*), e cila kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur.

### ***II.5.2 Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës***

Në kuadër të nenit 6 të “Rregullores për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, gjatë vitit 2012, pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur 6 raste transaksionesh të cilat nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës si pasojë e mospërbushjes së kriterit të ndryshimit të kontrollit të ndërmarrjeve objekt përqendrimi apo të mospërbushjes së kushtit të xhiros minimale të parashikuara në ligj.

Në tregun bankar janë shqyrtuar dy transaksione të cilat nuk janë konsideruar si objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Transaksioni i parë është ai i realizuar ndërmjet aksionerëve të Bankës Procredit Albania, Procredit Holding AG dhe Commerzbank, më anë të Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve”, e cila ishte nënshkruar më datë 24 Maj 2012 dhe në bazë të saj Commerzbank i ka transferuar të gjitha aksionet e saj (20%) tek Procredit AG e cila pas transaksionit është bërë zotëruesja e 100% të Bankës Procredit Albania. Meqenëse shoqëria Procredit AG zotëronte kontrollin (me anë të 80% të aksioneve), ky transaksion nuk ka sjellë ndryshime në strukturën e kontrollit të Bankës Procredit Albania.

Transaksioni i dytë ka qenë ai i realizuar ndërmjet palëve Banka Societe Generale Albania dhe Sogelease Albania, më anë të marrëveshjes së bashkimit të shoqërive nëpërmjet përthithjes, është nënshkruar më datë 18 prill 2012. Banka Societe Generale ka qenë shoqëria përthithëse ndërsa shoqëria Sogelease Albania ka qenë shoqëria e përthithur, bashkimi i shoqërive është bërë në kuadër të riorganizimit të aktivitetit bankar, përfshirë leasingu-n financiar, të Bankës Societe Generale Albania. Objekti i veprimtarisë së Banka Societe Generale Albania ka përfshirë edhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë Sogelease Albania. Duke qenë se shoqëria përthithëse Banka Societe Generale Albania ka qenë 100% aksionere e vetme e shoqërisë së përthithur Sogelease Albania, ky transaksion nuk ka sjellë ndryshime në strukturën e aksionerëve, të aksioneve dhe të kapitalin e shoqërisë Banka Societe Generale Albania.

Në sektorin strategjik të kërkim-shpimit të naftës, ka pasur një transaksion i cili është vlerësuar nga Autoriteti i Konkurrencës për rastin e shitjes-blerjes së 50% të kuotave të shoqërisë Petromanas Albania GmbH nga shoqëria ndërkombëtare Shell. Procesi i vlerësimit u iniciua nga informacioni i shtypit, i cili u vijua me plotësimin e informacionit nga palët në transaksion. Dy shoqëritë Petromanas Albania GmbH dhe Shell kishin hyrë në një marrëveshje transferimi të interesave e cila ka për objekt përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Kontrata me Ndarje Prodhimi për Kërkimin Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Blloqet 2-3 në tokë në Shqipëri, ndërmjet METE-s dhe Petromanas Albania.

Në bazë të nenit 53 “Detyrimi për njoftim” të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, shoqëria **Lotto Sport Sh.a** ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës “Kërkesën për autorizim të transaksionit të shit-blerjes së aksioneve të shoqërisë Lotto Sport Sh.a në masën 33.4% të aksioneve

e cila pas vlerësimit ligjor ka rezultuar se Transaksioni i realizuar në formën e zvogëlimit të aksionerëve nuk ka shkaktuar një ndryshim kontrolli brenda shoqërisë Lotto Sport Sh.a dhe për pasojë nuk ka përbërë një përqendrim i cili duhej të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës.

Në tregun e prodhimit të këpucëve, është vlerësuar transaksionin që ka sjellë si rezultat bashkimin me përthithje të shoqërisë Filanto Albania (shoqëria përthithëse) dhe shoqërisë Fabrika e Këpucëve Tiranë (shoqëria e përthithur). Shoqëria Fabrika e këpucëve Tiranë ka pasur si ortak të saj të vetëm shoqërinë italiane Filanto S.p.A, dhe vetë ajo ka zotëruar në masën 100% të kapitalit në shoqërinë përthithëse Filanto Albania. Operacioni ka pasur si objekt/pasojë të tij ndryshimin e kontrollit në shoqërinë Filanto Albania i cili ka ndryshuar duke kaluar nga kontroll indirekt në atë direkt nga shoqëria italiane Filanto S.p.A. Të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në këtë bashkim kanë qenë të zotëruara nga i njëjti ortak dhe operacioni i bashkimit nuk ka ndryshuar cilësinë e kontrollit në shoqërinë Filanto Albania e cila ka vazhduar të kontrollohet nga shoqëria Filanto S.p.A në mënyrë direkte.

Nga vlerësimi dhe shyrtimi i data-bazës nga QKR , Autoriteti ka vlerësuar edhe rastin e bashkimit të ndërmarrjeve “Meggle Albania” dhe “Ferlat” i cili nuk ka rezultuar të ketë qenë përqendrim pasi të dyja ndërmarrjet zotëroheshin nga të njëjtit ortakë të cili ishin pjesëtarë të të njëjtës familje.

## **II.6 Monitorimet e tregut**

### ***II.6.1 Tregu i hidrokarbureve (karburante dhe gaz i lëngshëm)***

Luhatjet e herë pas hershme të çmimit të shitjes se naftës dhe benzinës janë bere pjese e monitorimeve të vazhdueshme gjatë vitit 2012

Gjate monitorimit jane vlerësuar trendët e ndryshimit të çmimit në segmentet e tregut për të parë elasticitetin e tregut të brendshëm sipas ndryshimeve të çmimeve në tregun ndërkombëtar; struktura e tregut në kuptim të konkurrencës;(indeksi HHI); evidentimi i shenjave të mundshme të kufizimit të konkurrencës si pasojë e abuzimit të mundshëm me pozitën dominuese apo marrëveshjeve të mundshme të ndaluara; si dhe monitorimin e rekomandimeve për ndryshimin e akteve që mund të kufizojnë konkurrencën në treg.

Në përfundim të monitorimeve u konstatua se tregu i importit te karburanteve (benzine dhe diesel) është një treg mesatarisht i përqendruar, por me një përqendrim të konsiderueshëm në tre ndërmarrjet e para në treg. Nga analiza e strukturës së tregut rezulton se asnjëra nga ndërmarrjet nuk mund të sillet në mënyrë të pavarur nga konkurrentët dhe klientët e saj dhe nisur nga treguesi kryesor ai i pjesëve të tregut rezulton se asnjëra nga ndërmarrjet nuk ka pozitë



dominuuese individuale në tregun e karburanteve. Gjithsesi tre ndërmarrjet kryesore kanë rritur fuqinë e tregut duke çuar në një strukturë oligopolistike

Çmimi i shitjes se benzinës dhe dieselit ka pësuar vetëm rritje e cila ka ardhur për arsye të rritjes së çmimit në tregjet ndërkombëtare vendosjes si dhe aplikimi i pjesës së dytë të Taksës se Qarkullimit. Gjithahstu, nga të dhënat e Bankës se Shqipërisë për kursin e këmbimit te monedhës amerikane, ka rezultuar se kjo monedhe është rritur 8% gjate vitit 2012. Te gjithë këta faktorë kanë bërë që çmimi i importit te benzinës gjatë muajit prill 2012 të rritet 23 leke/litër krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kurse çmimi i dieselit në ne mars 2012 të jetë rreth 18.5 lekë më i lartë se muaji mars 2011.

Tregtaret e shumicës reagojnë menjëherë kur rritet çmimi i importit ose faktorë te tjerë te rritjes e çmimit por nuk ndjekin uljen kur ky çmim ulet. Tregu në segmentin fundor reflekton varianca në çmime çka përjashton mundësinë e fiksimit të çmimit por jo atë të koordinimit të sjelljes me ndryshime në të njëjtën shkallë të çmimeve. Nisur nga konkluzionet e monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës do të vijojë mbajtjen nën monitorim të tregut të karburanteve sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit për shkak të strukturës oligopolistike të tregut dhe tendencës në rritje të çmimeve të karburanteve.

Tregu i importit te gazit ka karakteristikat e një tregu oligopolistik me indeks shume të lartë përqendrimi ku ndërmarrja kryesore në treg gjate 2011 ka zënë 47% të tregut. Shkaku kryesor i rritjes se pjesës se tregut të ndërmarrjes kryesore është lidhja aksionare mes kësaj ndërmarrje dhe ndërmarrjes qe ofron shërbimin e ngarkim shkarkimit pranë portit të Porto Romanos. Duke ju referuar informacionin të siguruar nga procedurat e tjera (hetimi ne tregun e ngarkim shkarkimit në Porto Ramano), që nga viti 2011 pranë Porto Romanos kanë ngritur terminalët e depozitimit edhe ndërmarrje të tjera të importit të gazit të lëngshëm c'ka mendohet se do te rrisë konkurrencën mes ndërmarrjeve qe operojnë ne tregun importit dhe shitjes me shumice te gazit. Këto tregje do te vazhdojnë te jene ne monitorim te vazhdueshëm

### ***II.6.2 Produktet ushqimore: Sheqer, Oriz, Vaj Ushqimor***

Në zbatim të Vendimeve te Komisionit te Konkurrencës nr. 192 dhe 193 date 21.06.2011 si dhe Vendimit 194 datë 04.07.2011“Përmbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë orizit, vajit vegjetal dhe të sheqerit”, Sekretariatit të Autoritetit iu la detyrë monitorimi i këtyrë tregjeve.

Në përfundim të vlerësimit të tregjeve u konstatua se tregu i importit dhe shitjes se sheqerit mbetet një treg i përqendruar, por çmimet e shitjes me shumicë ndjekin trendin e çmimeve të importit. Tregu i importit të orizit karakterizohet nga një numër i madh importuesit të cilët operojnë si ne tregun e shumicës ashtu dhe ne

tregun e pakicës. Ne këtë treg ka hyrje dhe dalje te konkurrenteve dhe vihet re që tregu është dinamik në ndryshime të pjesëve në treg të ndërmarrjeve duke i dhënë tregut karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqendruar. Çmimi i importit dhe çmimi mesatar të shitjes me shumicë nuk kanë të njëjtin trend, sjellje që mund të vijë për faktin se këto ndërmarrje shesin oriz të pakëtuar nën markat e tyre dhe për më tepër shesin oriz të cilësive dhe llojeve të ndryshme. Nga krahasimi i çmimit të shitjes me shumicë të orizit nga tre ndërmarrjet e shumicës nuk na rezultojnë që ndërmarrjet të shesin më çmime të njëjta.

Oferta për vajin vegjetal plotësohet nga dy burime furnizimi, vaji i importuar dhe vaji i përpunuar në vend. Struktura e tregut të shitjes me shumicë të vajit përfshin si ndërmarrjet importuese ashtu dhe ndërmarrjet prodhuese të vajit. Treguesit e përqendrimit tregojnë për një treg në dinamike, me ndryshime të ndjeshme të treguesve, nga ku vihet re rritje e treguesve CR dhe HHI për vitin 2011 krahasuar me vitet e mëparshme.

Gjatë muajit gusht 2012, pranë Autoritetit të Konkurrencës u paraqit një ankese e cila shërbeu si indicio për monitorimin vetëm në tregun e vajit vegjetal, ku në bazë të fakteve të evidentuara gjatë monitorimit u propozua hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

### ***II.6.3 Tregu i importit të grurit.***

Vlerësimi i tregut të importit të grurit dhe prodhimit të miellit është vazhdimisht objekt monitorimi për shkak të impaktit që ka tek konsumatorët rritja e çmimit të bukës. Qëllimi i monitorimit ka qenë analiza e treguesve të konkurrencës për periudhën 2010- 2012 (CR3, CR5, HHI, Kurba e Lorencit) dhe ofertes së produktit në treg, ndryshimet në strukturën e tregjeve të integruara 2010-2012, analizën e çmimit në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

Në përfundim të analizës u konstatua se Indekset e përqendrimit japin karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqendruar, duke venë re një qëndrueshmëri të pjesëve të tregut për tre ndërmarrjet kryesore. Kurba e Lorencit tregon një përmirësim të tregut duke u bërë më konkurrencial nga viti 2008 deri në 2012

Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit të dollarit është reflektuar me një rritje prej 6.5% në çmimin e blerjes së grurit.

Persa i përket çmimit të shitjes së miellit në rrjetin e pakicës, janë konstatuar luhajtje të trendet rritëse dhe ulëse, kurse çmimi i bukës masive nuk ka ndryshuar.

#### ***II.6.4 Monitorimi i Tregut të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Landfill-in e Bushatit***

Monitorimi në tregun e menaxhimit të mbetjeve urbane në Komunën Bushat, Qarku Shkodër nisi me iniciativën e Sekretariatit dhe kishte si qëllim vlerësimin e aktorëve kryesor në të, mënyrën e funksionimit të tregut dhe të menaxhimit të shërbimit. Gjithashtu u konsultuan praktikantët me të mira evropiane dhe u zhvilluan takime me palët e interesit për të adresuar më mirë problemin në këtë treg nëse kishte shkelje të ligjit të konkurrencës apo jo.

Nga monitorimi u konkludua se “Nderkomunale Bushat” shpallte realizimin e depozitimit të mbetjeve urbane si dhe monitoronte mjedisin për shpangjen e impakteve negative. Tarifat e aplikuar nga kjo ndërmarrje ishin të njëjta për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në qarkun e Shkodrës dhe Lezhës. Në kontratat me palëve nuk aplikoheshin kushte diskriminuese.

Nga vlerësimi i legjisllacionit rezultoi se ndërtimi i landfill-ve ishte në nivel rajonal dhe menaxhimi i tyre lidhet me pushtetin vendor të bashkive dhe komunave dhe legjisllacioni përkatës nuk paraqet shenja të shtrembërimit të konkurrencës.

Landfill-i ka kapacitete të pashfrytëzuara dhe “Nderkomunale Bushat” shpallte rezultonte me humbje si shkak i depozitimit të një sasive më të vogël të mbetjeve urbane krahasuar me kapacitetet depozituese.

Komisioni i Konkurrencës, pasi u njoh me raportin dhe bazuar në problematikën e evidentuar gjatë monitorimit dhe në kuadër të interesit të përgjithshëm, nëpërmjet një shkresë drejtuar ministrave që kontrollojnë dhe njohin problematikën e këtij tregu për të ndikuar në rregullimin e tregut nëpërmjet Entit Rregullator të Ujit për një periudhë afatshkurtër ose për ngritjen e një Enti të Ri rregullator mbi menaxhimin e mbetjeve, përgjegjëse për licencimin e shoqërive, miratimin e tarifave dhe zbatimin e standarteve në këtë treg.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ka njoftuar Autoritetin e Konkurrencës se ka marrë në konsideratë rekomandimin dhe është në proces për rregullimin e këtij tregu nëpërmjet ndryshimeve në ligj “Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”. MPPT njofton se është ngritur grupi ndërministror i punës, i përbërë nga përfaqësues të MMPT, MMBAU, METE, MF dhe MB dhe Enti rregullator të Ujit dhe po punohet për amendimin e ligjit me qëllimin kalimin e kompetencave rregullatore në fushën e mbetjeve pranë ERRU-së.

### ***II.6.5 Tregu i farërave, fidanëve, tregu i produkteve për mbrojtjen e bimëve, tregu i plehrave kimike.***

Studimi i realizua në tregjet farërave, fidanëve, tregu i produkteve për mbrojtjen e bimëve, tregu i plehrave kimike ka patur për qëllim vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilën funksionojnë këto tregje si dhe evidentimin e strukturave të tregjeve dhe konkurrenteve në tregjet përkatëse. Ky monitorim u iniciua nga shqetësimet e paraqitura në Komisionin Ekonomik mbi këtë treg.

Nga vlerësimi i akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilët funksionojnë tregjet përkatëse u konstatua se nuk ka kritere specifike përjashtuese apo penguese për hyrjen dhe ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, importit apo tregtimit të produkteve përkatëse. Ligjet dhe aktet nënligjore përcaktojnë kritere të forta teknike mbi ruajtjen e cilësisë dhe sigurinë së produkteve si dhe përcakton kompetencat e enteve kontrolluese për sigurime të cilësisë së tyre. Në akte nuk u gjeten elemente të fiksimit të çmimit. Përsa i përket barrierave ekonomike, tregjet e marra në vlerësim, nuk kërkojnë investime të mëdha fillestare dhe kostot e hyrjes dhe daljes nga tregu janë të vogla duke mos sjelle barrierë ekonomike për hyrje dhe dalje nga tregu.

Përsa i përket strukturës së tregjeve dhe konkurrenteve në treg u konstatua se tregu i farërave, fidanëve dhe i produkteve për mbrojtjen e bimëve ka karakteristikat e tregjeve konkurrencial dhe mesatarisht të përqendruar, kurse tregu i plehrave kimike është një treg shumë i përqendruar.

Duke i vlerësuar të tre tregjet si tregje të varur nga njeri tjetrit, si dhe përqendrimin e njërit prej tyre, mungesën e kulturës së konkurrencës në sektorin e bujqësisë, Sekretariati vazhdoi studimin në këto tregje. Studimi u fokusua tek konsumatorët final të produkteve të tre tregjeve (fermerëve). Teknika kryesore për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve ishin pyetësorët dhe intervistat të cilat u plotësuan në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatoreve në qarqet Tirane, Durrës, Lezhë, Shkodër dhe Fier.

Për përpunimin e pyetësorëve është përgatitur një formë elektronike e cila është aktive në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës edhe për palët e interesuara.

### ***II.6.6 Monitorimin i tregut financiar kryesisht të marrëveshjeve mes bankave dhe shoqërive të sigurimit***

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në një shqetësim të përcjellë gjatë workshopit në Elbasan nisi monitorim në tregun financiar në lidhje me marrëdhënien midis bankave dhe shoqërive të sigurimit. Për efekt të këtij monitorimi, i cili fokusohet kryesisht në analizën e marrëdhënieve bankë & shoqëri sigurimi, tregu përkatës i produkti do të konsiderohet *tregu i shërbimit të sigurimit të pagesave të huas*.

Raporti i monitorimit është në proces shqyrtimi nga komisioni i Konkurrencës.

## **II.7 Kontrolli gjyqësor i Çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës**

Autoriteti i Konkurrencës ka shënuar progres në zbatimin e ligjit për rivendosjen e konkurrencës në treg nëpërmjet veprimit dhe ndëshkimit me gjobë të ndërmarrjeve për shkelje të ligjit në rastet e karteleve, abuzimit me pozitën dominuese, pengimin e inspektimeve dhe mosnjoftimin në kohë të përqëndrimeve. Por, doktrina e së drejtës së konkurrencës ka vërtetuar se efica e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në treg kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga zbatimi i vendimeve të tij.

Vendimet përfundimtare të Komisionit të Konkurrencës si rregull i nënshtrohen rishikimit gjyqësor në të gjitha shkallët dhe për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore si në Gjykatën e Shkallës së Parë, Apelit dhe Gjykatën e Lartë.

Nëse i referohemi statistikave, duke filluar nga viti 2005 që ka qënë vendimi i parë i Komisionit të Konkurrencës me penalitet e deri në fund të vitit të kaluar, janë ankimuar në Gjykatën e Shkallës së Parë 26 vendime të Komisionit të Konkurrencës. Nga shqyrtimi gjyqësor i tyre deri në fund të vitit të kaluar rezulton se janë fituar 15 raste, janë humbur 6 raste dhe janë në proces 5 raste. Ndërsa, në Gjykatën e Apelit janë apeluar 21 çështje, por vetëm 18 raste i janë nënshtuar shqyrtimit gjyqësor. Deri në fund të vitit të kaluar rezulton se nga çështjet që janë shqyrtuar në këtë gjykatë 11 raste janë fituar, 5 raste janë humbur dhe 2 raste janë në proces shqyrtimi. Në Gjykatën e Lartë janë bërë rekurs për 12 çështje nga të cilat janë fituar 2 çështje, është humbur 1 çështje dhe 9 çështje janë në proces. Pra, duke përmbledhur statistikën e mësipërme, të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar në shtojcën nr 5 “Pasqyra e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nga 26 çështje të ankimuara kanë përfunduar vetëm 3 çështje.

Gjithashtu, nëse i referohemi 17 vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, që janë për vendosje gjobe vetëm 8 vendime kanë marrë formë të prerë dhe janë kthyer tituj ekzekutiv, 1 vendim është humbur dhe 8 vendime janë në procesin e shqyrtimit në shkallë të ndryshme të gjyqësorit (3 vendime janë në shqyrtim në Gjykatë të Lartë). Këta janë treguesit e rrugës së gjatë të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, i cili ndërhyrë duke synuar mirëfunksionimin e tregjeve. Ky fakt përbën një nga problemet e që kufizojnë rritjen e efektit të ndërhyrjeve në treg në institucionin e konkurrencës.

Një aspekt tjetër shumë jetik i shqyrtimit gjyqësor, është mbrojtja që realizohet nga Autoriteti i Konkurrencës i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, i cili

fokusohet gjerësisht në argumentimin ligjor të shkeljeve të konstatuara dhe evidentimin me prova dhe fakte dhe elementë të tjerë sqarues për të mundësuar një rishikim gjyqësor sa më objektiv nga ana e Gjykatave. Në procesin e rishikimit Gjyqësor Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Komisionit që kanë marrë formë të prerë, Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Kodit të Procedurave Civile ka paraqitur në kohën e duhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të bërë të mundur ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë prej Zyrës së Përmbarimit. Nëse i referohemi shtoiçës nr 2 “Ekzekutimi i gjobave të të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës deri më 31 Dhjetor 2012”, 50 përqind e vendimeve të kthyer në tituj ekzekutiv janë arkëtuar 259.167.233 Lekë, të cilat përfaqësojnë shumën dhe pjesa tjetër janë në proces.

## **II.8 Përafrimi i legjislacionit**

Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, një hap i rëndësishëm është përqasja e plotë e legjislacionit në fushën e konkurrencës me atë të Acquis së BE-së. Zbatimi i zotimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, do të vazhdojë të mbetet prioritet në fushën e konkurrencës.

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012 është drejtuar drejt hartimit të akteve ligjore dytësore dhe më konkretisht janë miratuar ose janë në proces diskutimi me palët nga Komisioni i Konkurrencës rregulloret dhe udhëzimet e mëposhtme:

Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikat e bashkërenduara”(miratuar); Kjo rregullore është në zbatim të nenit 6 të Ligjit(përjashtimi i kategorive të marrëveshjeve) dhe ka për objekt përcaktimin me hollësi të kushteve që duhet të përmbushin marrëveshjet vertikale dhe praktikat e bashkërenduara për të përfituar nga përjashtimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 4 të Ligjit. Rregullorja është e përafruar plotësisht me Rregulloren e Komisionit Evropian Nr. 330/2010, datë 20.04.2010 Mbi Zbatimin e Nenit 101(3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Rregullorja "Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike" (miratuar); Në vijim të plotësimit të kuadrit nënligjor sipas parashikimeve të nenit 6 të ligjit dhe sipas PKZMSA është përafruar rregullorja për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve vertikale në

sektorin e mjeteve motorrike. Kjo rregullore është e përafruar me Rregulloren e Komisionit European Nr. 461/2010, datë 27.05.2010 “Mbi zbatimin e Nenit 101(3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, te kategori të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorrike”

Projekt/Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në Sektorin e Sigurimeve” (në proces diskutimi me palët e interesit); në zbatim të nenit 6 të ligjit dhe sipas parashikimeve të PKZMSA kjo rregullore është draftuar për kategoritë e marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve që përjashtohen nga ndalimi sipas nenit 4 të Ligjit. Kjo draft-rregullore është e përafruar me Rregulloren e Komisionit European Nr.267/2010, datë 24.03.2010 Mbi Zbatimin e Nenit 101(3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, te disa kategori të marrëveshjeve vertikale, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve.

Rregullorja “Për disa ndryshime në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”. Ndryshimet kishin për qëllim uljen e tarifave për ndërmarrjet e vogla që kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë. Sipas vendimit për këto ndërmarrje do të përgjysmohen tarifat dhe më konkretisht për njoftimin e përqëndrimit tarifa nga 15 000 bëhet 7.500 Lekë, për marrjen e autorizimit të një përqëndrimit të përkohshëm nga 300 mijë në 150 mijë lekë dhe tarifa për marrjen e autorizimit të përqëndrimit nga 500 mijë lekë në 250 mijë lekë

Udhëzuesi për kontrollin e përqëndrimit. Autoriteti i Konkurrencës ka përshtatur Njoftimin e Konsoliduar të Komisionit European për Kontrollin e Përqendrimeve në zbatim të Rregullores së Komisionit 139/2004. Qëllimi i këtij udhëzimi është parashikimi i rregullave që duhen zbatuar në vlerësimin dhe shqyrtimin e njoftimeve të përqendrimeve në përputhje me dispozitat e ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” si dhe të kuadrit nënligjor të Autoritetit të Konkurrencës për përqendrimet. Ky udhezues është në përputhje me Njoftimin juridik të konsoliduar të Komisionit sipas Rregullores së Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” (2008/C 95/01). Sikurse është parashikuar në PZKMSA është hartuar dhe miratuar në parim nga Komisioni rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve” në përputhje me rregulloren e Komisionit të BE-së Nr. 267/2010, të datës 24 Mars 2010 “Mbi zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve”. Kjo rregullore është publikuar në faqen e zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës dhe është në procesin e konsultimit publik

me palët e interesuara si shoqëritë e sigurimit, Byroja Shqiptare e Sigurimeve, Shoqata e Siguruesve dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

### **III. ADVOKATIA DHE KULTURA E KONKURRENCËS**

Legjislacioni në fushën e konkurrencës dhe në veçanti zbatimi i tij me efikasitet, janë një element vendimtar dhe faktor i rritjes ekonomike, që kërkon një politikë konkurrencë të përshtatshme e cila synon rritjen e efikasitetit ekonomik dhe mbrojtjen e interesit të ndërmarrjeve me synim mbrojtjen e konsumatorëve.

Advokatia e konkurrencës është një nga aspektet e ligjit, si dhe një objektiv i përhershëm të Autoritetit të Konkurrencës, i cili synon promovimin dhe nxitjen e konkurrencës nëpërmjet instrumentit të vlerësimit ligjor nga pikpamja e filozofisë së konkurrencës të akteve ligjore dhe nënligjore. Vlerësimi i draftëve apo akteve ligjore dhe nënligjore konsiston në analizën e efekteve që mund të sjellin ato në mirë-funksionimin e tregjeve si dhe kufizimeve potenciale që këto akte mund të sjellin në nivelin e konkurrencës.

#### **III.1 Vlerësimi i akteve dhe draft-akte normative**

Në krahasim me vitin 2011 u rrit numri i projekt-akteve normative të sjella për mendim dhe konsultim pranë Komisionit të Konkurrencës. Kjo tregon se ka pasur një rritje të ndjeshmërisë së enteve rregullatore dhe institucioneve qendrore lidhur me problemet e mbrojtjes dhe avokatisë së konkurrencës.

Në shtojcën nr 6 “Matrica e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës për vitin 2012 dhe zbatimi i tyre” paraqiten vlerësimet dhe rekomandimet e shrehura nëpërmjet vendimeve nga Komisioni i Konkurrencës adresuar enteve rregullatore apo institucioneve të tjera qendrore, bazuar në draftë aktet apo aktet ligjore dhe nënligjore të depozituara pranë Autoritetit për mendim, si dhe marrja në konsideratë e tyre. Por, aktiviteti i Autoritetit për promovimin e konkurrencës, shprehet jo vetëm opinionet e dhëna nëpërmjet vendimeve por edhe nëpërmjet formave të shkresore të komunikimit të cilat kanë kaluar në të njëjtin proces vlerësimi nga Komisioni i Konkurrencës.

#### **Në fushën e energjisë dhe gazit natyror**

- Komisioni i Konkurrencës me anë të shkresës nr.188, dat 15.03.2012 është shprehur mbi p/rregulloren e vendosjes së gjobave, duke i konfirmuar Entit Rregullator të Energjisë (ERE) se: draft rregullorja e paraqitur nuk bie ndesh me ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr.251/1, dt.5/4/2012, drejtuar ERE-së është shprehur për draft/rregulloren e “procedurave për vlerësimin e



tregut të gazit në Shqipëri” duke u shprehur se: tregu i gazit natyror në Shqipëri është një treg i pazhvilluar dhe nuk ka të dhëna për kapacitetet që duhen të merren në konsideratë nga TAP, nga ana e ERE-s duhet të kihet parasysh të mos krijohen barriera për hyrësit e rinj në treg, apo kufizime të tjera të konkurrencës.

- Komisioni i Konkurrencës është shprehur mbi ndryshimet e propozuara nga shoqëria KESH sh.a në lidhje me disbalancat në “Rregullat e tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike” duke cilësuar se: në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit në vendimin nr.159, dt.19.11.2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike” është shume e rëndësishme që në ndryshimet e paraqitura në rregullat e tregut të energjisë elektrike të saktësohet qartë roli i operatorëve në tregut sipas funksioneve përkatëse, pra roli i KESH Gen dhe furnizuesit Publik me Shumicë dhe jo të përgjithësohet roli i tyre duke e quajtur KESH sh.a.
- Kërkesës së ngritur nga “CEZ shpërndarje” sh.a për realizimin e importit të energjisë elektrike, Autoriteti i Konkurrencës ndër të tjera rekomandoi se: “AK e konsideron si një faktor shumë të rëndësishëm për konkurrencën dhe tregun e energjisë elektrike alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit dhe për këtë arsye është shprehur disa herë duke i qëndruar parimit të trajtimit të barabartë midis lojtarëve të tregut të energjisë elektrike. Si rrjedhojë, procedurat në fjalë të alokimit, duhet të garantojnë aksesin mbi baza jo-diskriminuese, transparente dhe konkurruese për të gjithë operatorët e licensuar në tregun e energjisë elektrike”.
- Autoriteti iu drejtua ERE-s lidhur me ndryshimet e propozuara nga shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a dhe Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike për kamat-vonesat dhe detyrimet e tjera ndërsjelltazi midis operatorëve të tregut. Konkretisht në të shprehet se: “Lidhur me kushtet e kamat-vonesës për faturat e shërbimeve të transmetimit dhe kushtet kontraktuale midis klientëve dhe furnizuesve të kualifikuar gjykohet se janë ceshtje teknik-specifike, për të cilat mund të trajtohen vetëm nga këndvështrimi i patrimeve të barazisë dhe midis operatorëve dhe për mbrojtjen e konkurrencës efektive në treg. Gjithashtu duhet patur parasysh se në këtë treg një pjesë e operatorëve janë ndërmarrje me pozitë dominuese, dhe atëherë si të tillë duhet të kenë parasysh përgjegjësitë dhe detyrimet e vecanta që kanë në marrëdhënie me operatorët e tjerë të tregut”.
- Lidhur me draft-rregulloren "Për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksionit", të ERE-së, Komisioni është shprehur se: p/rregullorja trajton probleme teknike të cilat nuk e prekin ligjin 9121. Gjithashtu Komisioni ka dhënë për ERE-n me Vendimin nr. 177, dt. 25.02.2011 rekomandim lidhur me mosvendosjen e kufizimeve mbi numrin e ofertave për zhvillimin e ankandeve.

### Në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare

- Lidhur me projekt-aktin e dokumentit të AKEP “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit” Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 231, datë 05.07.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”, i rekomandoi që: “të vendosë detyrimin për ndërmarrjen Albtelekom që gjithë shërbimet apo produktet që ALBTELEKOM ofron për konsumatorin të pasqyrohen apo të mbahen në llogari financiare të veçanta, duke përfshirë edhe kartën më parapagesë në telefoninë fikse ALBLUE. Kjo do të krijojë kushte që shërbimet/produktet të kenë transparencë në përcaktimin e kostove, si dhe do të parandalojë fenomenet antikonkurruese që mund të jenë pasojë e kostove joreale.”

### Në tregun financiar

- Lidhur me rregulloren së AMF-së Nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 247, dt. 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”, në pikën I.1. të tij ka vendosur: t’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: ndryshimin e pikës 3, të nenit 9 të Rregullores Nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, duke ulur afatin minimal për ndryshimin e primit të sigurimit.
- Lidhur me projekt-ligjin “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” ardhur në rrugë elektronike pranë AK-së, Autoriteti me shkresën e datës 28.12.2012, drejtuar AMF-së, është shprehur pa vërejtje mbi këtë projekt-ligj.

### Akte të tjera

- Me shkresën nr.594/1, dt.21.03.2012 drejtuar METE-s “Dhënie mendimi mbi p/ligjin “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se: “ky p/ligj në nenin 4, zbatimi i ligjeve të tjera, parashikon aplikimin e kërkesave dhe miratimin e rregullave të Autoritetit të Konkurrencës, sipas ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në rastin e bashkimeve ndërkufitare. Për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës është shprehur pa vërejtje apo komente.
- Me shkresën drejtuar MTKRS me nr.217/1, dt.03.05.2012 “Dhënie mendimi për projekt-ligjin “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me te” Komisioni ka

konfirmuar nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

### **Rritja e konkurrencës në prokurimet publike**

Lidhur me tregun e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike, si dhe Për Projekt-ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar” Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 243, dt. 11.09.2012 “Për dhënien e disa rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në prokurimet publike”, rekomandoi se:

I. Në projekt-ligjin e hartuar nga APP, në nenin 4, pika 2, përcaktohet se: Në nenin 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pas shkronjës “ç” të pikës 3, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje: “d) Kur ka një vendim të formës së prerë të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta”.

Të zëvendësohet fjala Autoritet me fjalën Komision, pasi organi vendimarrës është Komisioni i Konkurrencës. Pra të bëhet: “Kur ka një vendim të formës së prerë të Komisionit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta”.

II. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik të marre nismën ligjore që:

1. Në nenin 3 “Përkufizime” të shtohet një pikë me përmbajtjen vijuese:

“Marrëveshjet në oferta në prokurimet publike” janë një formë e marrëveshjeve për fiksimin e çmimit dhe/ose ndarjen e tregut në prokurime, të cilat ndodhin: Së pari, kur ndërmarrjet, që pritet të konkurojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për vlerën e ofertës së paraqitur duke eliminuar në këtë mënyrë konkurrencën për çmimin; dhe së dyti, ndërmarrjet bihen dakord se cila do të paraqesë ofertën me të ulët dhe të realizojnë rotacionin në atë mënyrë që çdo ndërmarrje të fitojë një vlerë të caktuar kontratash për të cilat është rënë dakort.”

2. Në nenin 46 (ose në ndonjë nen tjetër të përshtashëm) të shtohet një dispozitë ku të përcaktohet se:

“Që një ofertë të jetë e vlefshme (kualifikueshme) duhet që ajo të jetë përgatitur dhe paraqitur krejtësisht në mënyrë të pavarur nga ofertat e tjera konkurrese, si dhe operatorët e tjerë jo-ofertues”. Kjo mund të vërtetohet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e ofertuesve të “Çertifikatës për ofertë të pavarur”, rekomanduar APP-së për tu përfshirë në dokumentet standarde të tenderit me anë të Vendimit Nr.158, datë 12.11.2010 “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në Prokurimet Publike”.

3. Në nenin 56 “Oferta anomalisht e ulët” të ligjit, të përcaktohet një afat kohor i mjaftueshëm brenda të cilit operatorët ekonomik duhet të paraqesin argumentet e tyre mbi ofertat anomalisht të ulëta.

4. Në nenin 61 “Nënkontraktimi” të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, të shtohet një pikë ku të përcaktohet se:

“Autoriteti Kontraktor nuk do të lejojë në asnjë rast nënkontraktimin midis ofertuesve pjesmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi, pasi kjo sjellje është në kundërshtim me parimin e ofertimit në mënyrë të pavarur, si dhe nuk do të lejojë nënkontraktimin për ato kontrata të cilat, për nga natyra e vazhdueshme dhe specifike e tyre, duhet të kryhen nga vetë kontraktuesi”.

*Gjithashtu mos lejimi i nënkontraktimit si më sipër të përcaktohet edhe në kreun përkatës të VKM-së mbi rregullat e prokurimit publik.*

*III. Në funksion të rritjes së transparencës dhe të konkurrencës në prokurimet publike, gjatë zhvillimit dhe në përfundim të procedurave të prokurimit nga Autoritetet Kontraktore të publikohen të gjitha dokumentet lidhur me këto procedura (kryesisht: formularin e plote të njoftimit të fituesit dhe formularin e plotë të nënshkrimit të kontratës së lidhur), si dhe të mundësohet ruajtja e tyre në faqen zyrtare elektronike të APP-së, në vite.*

## **III.2 Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe udhëzues mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës**

Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme publike është një faktor i rëndësishëm që ndikon në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë mënyrë bashkëpunimi me Institucionet Qendrore, Vendore dhe sidomos me Entet Rregullatore, ka një rëndësi të veçantë. Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar ngushtësisht me Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Entin Rregullator të Energjisë, Entin Rregullator të Ujit, etj.

Bashkëpunimi është kryer si në mënyrë shkresore ashtu edhe me anë të takimeve dypalëshe të drejtpërdrejta të Komisionit të Konkurrencës, dhe drejtuesve të këtyre enteve. Gjithashtu, anëtarë të stafit të Autoritetit të Konkurrencës janë konsultuar me anëtarë të stafeve të këtyre institucioneve sa herë ka qenë e nevojshme në kuadër të procedurave të ndryshme hetimore apo konsultative.

Një formë tjetër bashkëpunimi është kryer edhe në kuadër të trajnimeve, workshop-eve, e konferencave të cilat kanë trajtuar çështje të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës në sektorët e rregulluar si dhe marrëdhëniet e institucioneve përkatëse. Disa nga këto aktivitete janë zhvilluar me mbështetjen e Komisionit European në kuadër të programit IPA-2008, për mbështetjen e Autoritetit të Konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

Në kuadër të hetimeve për shkeljet e konkurrencës në tregun e prokurimeve publike, Autoriteti ka pasur bashkëpunim të frytshëm edhe me Agjencinë e Prokurimeve Publike. Kështu është zhvilluar një trajnim për stafet e njësive të prokurimit të institucioneve të ndryshme për të shmangur shkeljet e konkurrencës gjatë procedurave të prokurimeve publike të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme. Gjithashtu në këto trajnime janë shpërndarë dhe promovuar edhe disa

udhëzues të ndryshëm për parandalimin dhe zbulimin e marrëveshjeve të fshehta në prokurime publike të përgatitura e botuara me mbështetjen e projektit IPA.

Autoriteti i Konkurrencës ka nënshkruar edhe Memorandume Mirëkuptimi me institucione të ndryshme në mënyrë që të nxitet bashkëpunimi ndër-institucional veçanërisht në drejtim të shkëmbimit të të dhënave dhe bashkëpunimit për promovimin e konkurrencës. Kështu, Autoriteti i Konkurrencës ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Autoritetin e Aviacionit Civil. Në bazë të këtij memorandumi, palët bashkëpunojnë për rritjen e konkurrencës së lirë dhe efektive duke shkëmbyer informacion, bashkëpunuar për studime tregu, duke shqyrtuar bashkërisht propozimet për rregullime ligjore në rastet e kufizimeve sasiore për hyrjen në tregun e transportit ajror etj.

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës, ka nënshkruar një memorandum të ri Bashkëpunimi, me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Miratimi i këtij memorandumi të ri u bë i domosdoshëm për shkak të ndryshimeve në kuadrin ligjor të procedurave tatimore. Në bazë të këtij memorandumi, palët do të bashkëpunojnë për sigurimin e të dhënave të domosdoshme për kryerjen e analizave e mbikëqyrjes së tregut, si dhe vlerësimit të akteve normative të nxjerra nga DPT. Veçanërisht do të konsultohen me Autoritetin e Konkurrencës ato akte të cilat mund të vendosin kufizime për hyrjen në treg të subjekte të ndryshme, apo imponimin e praktikave të njëjta me çmimet apo kushtet e shitjes.

Autoritetit të Konkurrencës me synimin e rritjes së kontrollit dhe të luftës ndaj marrëveshjeve të ndaluara në prokurimet publike ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Këto institucione angazhohen se do të bashkëpunojnë veçanërisht në drejtim të zbulimit të shkeljeve të mundshme të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës gjatë procedurave të prokurimit publik të cilat kontrollohen nga KLSH-ja.

### **III.3 Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat**

Për një zbatim sa më të mirë të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës është e domosdoshme që të ketë në rritje të ndërgjegjësimit të publikut dhe të kulturës së konkurrencës. Ky është edhe një nga prioritetet e vazhdueshme të punës së Autoritetit të Konkurrencës. Informimi sa më i plotë i publikut është edhe një detyrim në kuadër të parimit të transparencës së veprimtarisë së institucionit dhe funksionarëve të tij.

Në këtë kuadër informimi publik është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të faqes së internetit të Autoritetit të Konkurrencës, si dhe aktiviteteve informuese të

zhvilluara me mbështetjen e projektit IPA, në disa nga qytetet kryesore të vendit, si Shkodra e Elbasani, e Tirana.

Gjithashtu, janë shpërndarë për personat e interesuar edhe publikimet e ndryshme të Autoritetit të Konkurrencës të botuara në vitet e kaluara me financimin e vetë Autoritetit të Konkurrencës nga fondet e buxhetit të shtetit apo me mbështetjen e programit IPA.

Informimi i publikut është bërë edhe me anë të deklaratave e intervistave për median e shkruar dhe audiovizive. Ky instrument është përdorur jo vetëm për njoftimet për përfundimin e procedurave hetimore, por edhe për të qënë pjesë e Dites Botërore të Konkurrencës.

Një pjesë e stafit të Autoritetit të Konkurrencës është e angazhuar edhe me veprimtari mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor dhe e ka shfrytëzuar këtë mundësi për të promovuar punën e autoritetit të konkurrencës dhe rritjen e kulturës së konkurrencës.

### ***III.3.1. Marrëdhënia me publikun***

**website:** Në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al) ofrohet një informacion i detajuar në lidhje me aktivitetin e institucionit. Kjo faqe, shërben për të informuar publikun e gjerë, biznesin, mediat OJF-të dhe personat që merren me kërkim shkencor. Faqja e internetit përditësohet vazhdimisht për veprimtarinë dhe informacionet për Autoritetin e Konkurrencës, kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës, aktivitetin e Komisionit të Konkurrencës, publikimet, etj. Në këtë faqe publikohen sapo zbardhen vendimet e Komisionit të Konkurrencës në kohë reale. Gjithashtu, në këtë faqe publikohen edhe informacione për përqendrimet që priten të ndodhin me qëllim që palët e interesuara të kenë mundësinë që të shprehin dhe të sjellin opinionet e tyre në lidhje me këto përqendrime. Faqja zyrtare e internetit të Autoritetit të Konkurrencës është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Gjatë vitit të kaluar kjo faqe është ndryshuar për sa i përket strukturës, dizenjimit dhe programimit për ta bërë sa më tërheqëse dhe interaktive për publikun si dhe për të lehtësuar aksesin në të.

Faqja zyrtare e internetit e Autoritetit të Konkurrencës është plotësisht e integruar edhe me rrjetet sociale Facebook, LinkedIn dhe Tweeter ku çdo informacion i faqes mund të postohet nga çdo i interesuar në këto rrjete në mënyrë të menjëhershme.

**Publikimet:** Në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i publikut e aktorëve të ndryshëm Autoriteti i Konkurrencës, ka publikuar Buletinin e Vendimeve dhe

Raportin Vjetor për vitin 2012. Këto publikime janë një ndihmesë për biznesin, për institucionet qendrore, rregullatorët, publikun e gjerë etj.

Gjithashtu Autoriteti gjatë aktiviteteve të ndryshme ka promovuar e shpërndarë publikimet e bëra në vite si: Politika e Konkurrencës; Fjalorthi i Konkurrencës; Buletinet e Vendimeve; Raportet Vjetore; Përmbledhje e Kuadrit Ligjor parësor dhe dytësor në fushën e konkurrencës; Broshurë informative “E drejta e konkurrencës në Shqipëri”; Broshurë “Konkurrenca në prokurimet publike: Si të parandalohen dhe zbulohen marrëveshjet e ndaluara në prokurimet publike”; Fletëpalosja “Konkurrenca në prokurimet publike”; Broshurë “Vlerësimi i ndikimit rregullator dhe konkurrenca në tregjet e rregulluara”; Broshurë “Koncensionet, konkurrenca dhe rregullat e ndihmës shtetërore, një listë analitike për identifikimin e disa çështjeve kritike”. Etj.

### ***III.3.2. Marrëdhënia me median***

Aktivitetet e Autoritetit të Konkurrencës dhe veçanërisht vendimet e tij janë pasqyruar gjerësisht nga mediat e shkruara dhe audio-vizive, duke treguar një vëmendje të veçantë për pasqyrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar komunikimin me mediat me anë të njoftimeve për shtyp, intervistave, konferencave të shtypit, pjesëmarrjes në programe të ndryshme televizive etj. Njoftimet për mediat për vendim-marrjet e Komisionit dhe për aktivitetet e ndryshme të Autoritetit, janë përgatitur nga ana e Kabinetit dhe i janë shpërndarë medias vendase, përfaqësuesve të medias së huaj në vend si dhe agjencive ndërkombëtare të specializuara të lajmeve e inteligjencës së tregjeve si MLEX, ILO, CPI etj. ku kanë gjetur një pasqyrim të gjerë.

Ky komunikim me publikun me anë të mediave ka ndikuar ndjeshëm për promovimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, si dhe në rritjen e kulturës së konkurrencës dhe ndërgjegjësimit të publikut. Kjo si në drejtim të publikut të specializuar (akademikë, ekonomistë, juristë, biznesmenë, zyrtarë publikë etj.) ashtu edhe ndaj publikut të gjerë, i cili është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimet e Autoritetit të Konkurrencës.

## **IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

Rritja e rolit të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të konkurrencës ka qënë një nga objektivat për të cilën është punuar gjatë vitit 2012. Për më tepër, institucioni i konkurrencës është pjesë e rrjetit ndër-institucional të integritit, i cili luan rol koordinues për një kapitull të veçantë, si dhe kontribuon në plotësimin e detyrimeve dhe raportimin edhe të

kapitujve të tjerë. Gjatë këtij viti janë rikonfirmuar edhe njëherë nga ana e Autoritetit të Konkurrencës grupet nderinstitucionale të punës lidhur me Kapitullin 8, duke realizuar kështu detyrën e institucionit të kordinues i këtij kapitulli.

#### **IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin Europian**

Sipas Raportit të Komisionit Europian për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka bërë disa përparime në fushën e konkurrencës dhe pasqyron një progres të konsiderueshëm për sa i përket mbrojtjes së konkurrencës dhe fushës së konkurrencës në përgjithësi.

##### ***Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Kapitulli: Politika e Konkurrencës***

*Progres ka pasur në fushën e anti-kartelit dhe përqendrimeve. Rregullorja për marrëveshjet me rendësi të vogël e miratuar në Nëntor është e përafër me legjislacionin e acquis. Autoriteti i Konkurrencës morri 6 vendime në fushën e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet) dhe dy në fushën e abuzimit me pozitën dominuese. Janë autorizuar 10 përqendrime të njoftuara brenda afatit. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës leshoi 3 rekomandime drejtuar 3 institucioneve të tjera. Ai i dha rekomandim AKEP-it për sa i përket një përqendrimi mes dy operatoreve telefonik dhe mori reagim pozitiv nga ky institucion.*

*Autoriteti i ka dhënë një rekomandim edhe Bankës së Shqipërisë mbi marrjen e masave për rritjen e transparencës nga ana e Bankës së Shqipërisë për publikimin në faqen e saj të internetit të komisioneve dhe normave të interesit për shërbimet dhe produktet e ofruara nga bankat por kjo e fundit s’e ka marrë akoma parasysh rekomandimin e këtij institucioni për vendosjen e Ombudsman-it Bankar.*

*Autoriteti i Konkurrencës ka perfunduar hetimet në tregun e bukës, sigurisë fizike si dhe ka vendosur gjoka për marrëveshje në fiksimin e cmimit. Pas hetimit në tregun e telefonisë fikse me parapagese Autoriteti i Konkurrencës leshoi dhe disa rekomandime. Ak gjithashtu ka hapur hetim paraprak në disa sektore për abuzim të mundshëm me pozitën dominuese si: Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj paleve të treta (TPL), tregu i transportit detar, ngarkim shkarkimi i gazit të lëngshëm, tregu i importit të sheqerit dhe orizit, tregu i prodhimit të vajit vegjetal si dhe importimi i tij, prodhimi dhe shitja me shumicë në tregun e cimentos.*

*Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar me aktivitete lidhur me konsultimin publik, kusht ky për zbatimin e politikës së konkurrencës. Progres është vënë re edhe në drejtim të kapaciteteve administrative. Numri i punonjësve është rritur me marrjen në punë të një eksperti juridik por do të rritet akoma kur të perfundojë procedura e rekrutimit të një eksperti IT dhe forensic-u. Nderkohe dy pozicione administrative janë kthyer në pozicione teknike sipas strukture së re të Ak të miratuar në Janar të këtij viti. Trajnimet kanë qenë një ndihmë e madhe në forcimin e kapaciteteve hetuese (investigative).*

##### ***Përfundim***

*Është vënë re progres në fushën e konkurrencës. Kërkohe akoma me shumë përpjekje në shtimin e kapaciteteve administrative dhe ruajtjen e pavarësisë institucionale të Autoritetit të Konkurrencës.*



Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të Raportit të Stabilizim-Asociimit për vitin 2012, analizoi rekomandimet e bëra në këtë raport në lidhje me Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, duke nxjerrë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete që parashikonte ky raport dhe duke i kthyer ato në një plan masash administrative për zbatim dhe plotësimin e tyre. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve janë ndarë përgjegjësitë konkrete sipas sektoreve dhe drejtorive të Autoritetit, ku përcaktohen objektivat e përcjella nga ky raport në drejtim të nismave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Autoriteti i Konkurrencës, si institucioni koordinues për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës” i ka kushtuar rëndësinë maksimale procesit të raportimit të progresit të ndodhur jo vetëm në fushën e konkurrencës, por edhe në fushat për të cilat raporton institucioni. Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtësisht me anëtarët pjesëtarë të grupit ndërinstitucional të punës për Kapitullin 8 në mënyrë që të pasqyrohet sa me realisht dhe qartësisht situata aktuale përsa i përket kuadrit ligjor, aktiviteteve zbatuese, procesit të vlersimit të konkurrencës dhe ndërhyrjes në tregjet e rregulluara, dhënies së mendimeve dhe opinioneve për të drejtat e vecanta dhe eksklusivitetet etj.

Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është siguruar paraqitja prane MIE e materialit “Mbi Nënkomitetin për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në Prill 2012”. Autoriteti i Konkurrencës prezantoi rezultatet e arritura në procesin e përfarimit dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

#### ***IV.1.1 Detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimi-Asociimit për Autoritetin e Konkurrencës***

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është instrumenti European, i cili do të mundësojë integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin European, duke krijuar kuadrin e duhur për forcimin e shtetit ligjor. Kjo marrëveshje parashikon adoptimin e *acquis communautaire* (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm european, me synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë.

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Autoritetin e Konkurrencës lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, dhe ka të bëjë me aftësinë për të përballuar detyrimet e anëtarësisë në BE, dhe konkretisht janë nenet 71 dhe 72 të MSA që parashikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e

Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës nga veprimet dhe praktikant antikonkurrese që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë (NENI 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike” ) si dhe detyrat që parashtrohen para AK-së në rastet e të drejtave eksklusive apo të veçanta, të cilat me ndryshimet e fundit që pësoi Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” në tetor të 2010, zënë një vend të veçantë dhe ka një dispozitë konkrete pikërisht për zbatimin dhe respektimin e këtyre rregullave ( NENI 72 “Sipërmarrjet publike “)

#### ***IV.1.2 Raportimi periodik***

Autoriteti ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integrimit Europian dhe ka përcjellë raporte, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur nga Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti ka raportuar në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së,(PKZMSA) si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me acquis të akteve juridike të miratuara në fushën e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka raportuar sipas kërkesave të vetë Ministrisë së Integrimit duke mbuluar fushën e konkurrencës dhe fushat për të cilat AK është koordinator e Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”. Kanë vazhduar raportimet periodike 2 mujore (me formën Follow up) dhe 3 mujore në lidhje me zhvillimet legjislativë, masat dhe projektet e kapacitetin institucionale në lidhje me periudhën raportuese pranë (me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integrimit) Komunitetit Europian,; raportim vjetor në lidhje me të gjitha zhvillimet në fushën e konkurrencës, bashkëpunimit dhe procedurat hetimore të ndërmarrja, vendimet e Komisionit të Konkurrencës, proceset e ndryshme dhe monitorimet e tregut, forcimi i kapaciteteve institucionale, rishikim dhe përditësim me legjisllacionin më të fundit komunitar në këtë fushë etj.

AK si një nga institucionet përgjegjëse për një nga kapitujt kryesore për të cilat Shqipëria do të negociojë, i ka kushtuar vëmendjen maksimale procesit të integrimit Europian, duke u përgjigjur me saktësi, rigorozitet, në respektim të afateve dhe sa më realisht për situatën në të cilën ndodhet fusha e konkurrencës në periudhat përkatëse. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon adoptimin e acquis communautaire (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi I përafrimit të legjisllacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm europian me synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë.

#### **IV.1.3 Projekti i mbështetjes IPA 2008**

Projekti i “binjakëzimit” IPA 2008, ofroi për Autoritetin e Konkurrencës dhe Ndihmen Shtetërore asistencë në rritjen e profesionalizmit dhe të eksperiencës së stafit të AK-së nëpërmjet trajnimeve dhe ofrimit të ekspertizës së ekspertëve italianë dhe hungarezë të autoriteteve respektive të konkurrencës, në shqyrtimin e rasteve konkrete dhe atyre hipotetike për marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe kontrollin e përqëndrimeve, në forcimin e marrëdhënieve me rregullatorët dhe konkretisht në sektorin financiar, bankar, telekomunikacioneve, energjisë, ujit etj, në organizimin e eventeve të përbashkëta me rregullatorët dhe me vendet e rajonit, bashkëpunimi me gjykatat etj.

Synim i projektit ishte forcimi i kapaciteteve institucionale të AK-së, si një nga rekomandimet kryesore të Komisionit European në progres raportet e viteve të fundit si dhe i sektorëve të veçantë rregullatorë dhe sistemit gjyqësorë për sa i përket zbatimit të rregullave të konkurrencës. Target grupi kryesor që synonte projekti ishin edhe bizneset, studentët e drejtësisë dhe të shkollës së magjistraturës, gjyqtarët, përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe atyre lokale, si dhe vetë publiku i gjerë.

#### **IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest)**

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) ka në qëndër të politikave të saj edhe konkurrencën, si një nga fushat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe sfidave globale të rritjes dhe prosperitetit.

Për vendet e rajonit, Qendra Rajonale e Konkurrencës(RCC) në Budapest, ka shërbyer si qendra kryesore e trajnimit për ekspertët për fushat kryesore të zbatimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës.

Ashtu si çdo vit, OECD-RCC ka financuar trajnimin e ekspertëve të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012 në fushat e abuzimit me pozitën dominuese(raste hipotetike), mbrojtja gjyqësore e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, marrëveshjet vertikale, analizën e përqëndrimeve dhe dhënien e përqëndrimeve me kushte dhe detyrime, analizën e instrumentave për zbulimin e kartelevë etj.

#### **IV.3. Bashkëpunimi me Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN) dhe Autoritet e Rajonit**

Autoriteti i Konkurrencës, është një anëtar me të drejta të plota i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN). Ky organizëm i rëndësishëm ndërkombëtar, përbëhet nga agjenci të ndryshme të konkurrencës nga mbi 100 vende të ndryshme të botës, si dhe organizata të tjera të biznesit dhe ndërkombëtare. Kjo organizatë ka si synim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve anëtare

duke arritur një konvergjencë ndërmjet legjislacioneve dhe praktikave më të mira të zbatimit të ligjeve. AK ka marrë pjesë aktive në konferencën vjetore të ICN, në seminarët telematike që zhvillon kjo organizatë si dhe në plotësim pyetësorësh e dhënie mendimesh për dokumente të ndryshme të përgatitur nga grupet e ndryshme të punës të kësaj organizate.

Duke pasur parasysh integrimin gjithnjë e më të madh të tregjeve rajonale për një treg sa më konkurrues është e domosdoshme që të ketë një bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të Rajonit. Në këtë kuadër janë intensifikuar bashkëpunimet me autoritetet e konkurrencës të rajonit në kuadër të iniciativave të ndryshme rajonale. Veçanërisht i rëndësishëm është bashkëpunimi me Komisionin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës. Ky bashkëpunim është shtrirë në kuadër të vizitave në nivel titullarësh dhe ekspertësh si dhe shkëmbim përvojash për çështje të ndryshme me interes të ndërsjellë.

**Forumi i Konkurrencës, Sofie.** Shqipëria ka mbështetur aktivisht, funksionimin ngritjen dhe zgjerimin e Forumit të Konkurrencës së Sofies. Kjo iniciativë e rëndësishme rajonale në fushën e konkurrencës, ka si qëllim që të nxisë bashkëpunimin autoriteteve të konkurrencës të vendeve të Rajonit të Ballkanit. Ky bashkëpunim synon një zbatim sa më uniform të rregullave të konkurrencës në këtë rajon. Ky forum do të ndihmojë vendet e Ballkanit që të maksimizojnë përfitimet që vijnë nga një treg konkurrues dhe funksional rajonal.

Ky bashkëpunim do kryhet me anë të rritjes së kapaciteteve të vendeve pjesëmarrëse duke organizuar aktivitete të ndryshme mbi të drejtën e konkurrencës, mbajtjen e një database me material informues dhe edukative zhvillimi i një platforme online bashkëpunimi etj. Bashkëpunimi do të ndihmojë edhe në kuadër të plotësimit të detyrimeve të vendit tonë në fushën e konkurrencës për integrimin e Shqipërisë në BE.

Ky forum është mbështetur nga organizma prestigjiozë ndërkombëtarë si UNCTAD, OECD, ICN dhe Bashkimi European. Vendet pjesëmarrëse janë Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia. Ndërsa mbështetje për këtë iniciativë do të ofrohet edhe nga Sllovenia, Rumania, Greqia, Turqia, Rusia, Ukraina, Austria, Zvicra.

**Rrjeti i Konkurrencës i Komunitetit të Energjisë.** Shqipëria gjithashtu është një nga themelueset e Rrjetit të Konkurrencës të Komunitetit të Energjisë të përbërë nga vendet e Bashkimit European dhe vendet e tjera anëtare të Komunitetit të Energjisë. Qëllimi i këtij rrjeti është nxitja e bashkëpunimit dhe diskutimit mbi zbatimin e së drejtës së konkurrencës në sektorin e energjisë. Anëtarët e këtij rrjeti


do të shkëmbejnë përvojat dhe praktika më të mira në sektorin e energjisë. Ky bashkëpunim është shumë i rëndësishëm pasi shumica e palëve pjesëmarrëse kanë një strukturë tregu të ngjashme dhe përballen me të njëjtat problematika. Anëtarë të kësaj iniciative janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Komuniteti European, Sllovenia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Ukraina, dhe Kosova.

## V. BURIMET NJERËZORE DHE FUNKSIONET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS


### V.1 Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës

Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës gjate vitit 2012 nuk ka patur ndryshime thelbësore dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 7 datë 02.02.2012, ndërsa numëri i punonjësve është 35 nga të cilët 24 vete janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (12 ekonomistë 9 juristë 2 informaticiene dhe 1 gjuhe e huaj) si dhe nje personeli mbeshtetes.

**Ndarja e stafit sipas funksioneve**



## Ndarja e stafit sipas arsimimit



### V.2 Struktura organizative

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor.

Gjatë vitit të kaluar Komisioni i Konkurrencës u plotësua me anëtarin e pestë Znj. Iva Zajmi, si dhe u zgjodh Z/Kryetarja Znj. Rezana Konomi. Bordi vendimmarrës i institucionit të konkurrencës ka në përbërjen e tij 3 ekonomistë dhe 2 juristë, pothuajse të gjithë me tituj dhe grada shkencore.

Në shtojcën nr. 7 “Struktura e Autoritetit të Konkurrencës” bashkelidhur këtij raporti është vendosur organograma e Autoritetit të Konkurrencës, e cila tregon se nuk ka ndryshime në strukturën organizative si dhe në funksionet e hallkave përbërëse të institucionit të konkurrencës.

Misioni i Autoritetit të Konkurrencës është sigurimi i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet zbatimit të instrumentave të ndërhyrjes në treg të parashikuara në Ligjin nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar për kufizimet e konkurrencës nga abuzimi me pozitën dominuese dhe/ose marrëveshjet e ndaluara. Autoriteti i Konkurrencës ka për detyrë edhe kontrollin e përqëndrimeve duke analizuar ndryshimet në strukturat e tregut si pasojë e bashkimit të ndërmarrjeve ose ndryshimit të kontrollit për të ndaluar përqëndrimet që krijojnë ose forcojnë pozitën dominuese dhe që mund të ndikojnë në konkurrencën efektive në treg.

### **V.3 Rritja e kapaciteteve administrative**

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative përbën një nga sfidat e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës, është konsideruar si një faktor jetik për rritjen reale të pavarësisë së institucionit të konkurrencës.

Në vitin 2012, është realizuar një numër i madh i trajnimeve për stafin e Autoritetit të Konkurrencës. Rreth 100 ditë trajnimi për inspektorët dhe stafin menaxherial të Autoritetit të Konkurrencës janë zhvilluar nga ekspertët e vendeve të Bashkimit Europian, Italia dhe Hungaria. Tematikat e trajnimit janë fokusuar si në aspektin e tregjeve më të rëndësishëm ku ndërhyjnë Autoriteti i Konkurrencës, ashtu dhe sipas ndarjes horizontale, abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara, kontrolli i përqëndrimeve e tjera.

Në kuadër të Programit të BE, IPA 2008, Autoriteti edhe gjatë vitit 2012 ka përfituar nga zbatimi i programit të binjakëzimit. Objekti i këtij programi është sikurse dhe një vit më parë, është sigurimi i një mjedisi konkurrues në Shqipëri, duke zbatuar ligjin në fushën e konkurrencës dhe në përputhje me Acquis Communautaire, si dhe rritja dhe forcimi i efikasitetit dhe efektivitetit të kapaciteteve administrative në fushën e konkurrencës.

Në kuadër të bashkëpunimit me qendren rajonale të OECD-së në Hungari janë zhvilluar 18 ditë kalendrike trajnime nga stafet teknike ku janë trajnuar për çështje të ndryshme të konkurrencës. Gjithashtu, stafet teknike kanë marrë pjesë në të gjitha seminarët apo tryezat e rrumbullakta të realizuara nga entet rregullatore, apo dhe institucionet e tjera.

### **V.4 Manaxhimi financiar**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2012 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit Nr.10.487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”. Administrimi i vlerave materiale dhe monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korrektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore.

Spektori i financës në këtë institucion planifikon dhe ndjek miradministrimin e shpenzimeve buxhetore të miratuara, të cilat janë të lidhura me aktivitetin e institucionit, Në tërësinë e vet ky sektor ka ndikuar në realizimin e objektivave që ka institucioni.

Buxheti i miratuar për vitin 2012 është realizuar në masën 91.7%. Informacioni i detajuar jepet në pasqyrën e paraqitur në shtojcën nr.8 “Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2012” Mosrealizimi në masën 8.3% ka ardhur kryesisht

nga mosrealizimi i nje procedure prokurimi (mungese ofertash) dhe pjesa tjeter mbetje ne prokurimet e tjera të realizuara gjatë vitit 2012.



## **VI. PRIORITETET PËR VITIN 2013**

Autoriteti i Konkurrencës për përcaktimin e prioriteteve bazohet në vlerësimin objektiv të eksperiencave dhe problematikave të vitit të kaluar si dhe në identifikimin e sfidave të së ardhmes, duke u udhëhequr nga vizioni i Komisionit të Konkurrencës, për një rritje të vazhdueshme të efektivitetit të ndërhyrjeve në treg të institucionit të konkurrencës.

Forcimi i instrumentave të bashkëpunimit me gjyqësorin do të jetë një nga prioritetet për vitin e ardhshëm të Autoritetit të Konkurrencës, pasi vetë eksperiencia me gjyqësorin gjatë vitit të kaluar, shtron si domosdoshmëri përcjelljen dhe absorbimin e filozofisë së konkurrencës, si një fenomen bashkëshoqërues i ekonomisë së tregut, ku mosrespektimi i lojës së lirë të operatorëve në treg rrit ndjeshëm kostot e të mirave publike dhe për rrjedhojë ul mirëqënien konsumatore.

Rritja e efektivitetit të instrumentave të kapaciteteve institucionale, të cilat konsistojnë në përsosjen e metodave, mjeteve dhe menyrave të investigimit si dhe në rritjen e shkallës së profesionalizmit të personelit të institucionit të konkurrencës. Sfidat e së ardhmes janë orientuesit e ndërtimit të strategjive nga Komisioni i Konkurrencës, jo vetëm në zbatim të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës, por për të rritur rolin e promovimit të konkurrencës si një nga rrugët e sigurta për rritjen ekonomike të vendit.

### **VI.1. Zbatimi i ligjit të konkurrencës**

Gjatë vitit 2013 prioriteti kryesor i punës së Autoritetit të Konkurrencës do të jetë mbrotja dhe promovimi i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet rritjes së efikasitetit të ndërhyrjeve në treg, duke sofistikuar instrumentat dhe procedurat hetimore për evidentimin dhe parandalimin e kartelevë, abuzimin me pozitën dominuese dhe kontrollin e përqëndrimeve që ndodhin në tregun e brendshëm.

Objekti i punës së institucionit të konkurrencës gjatë vitit 2013 është përfundimi apo vazhdimi i monitorimeve dhe i procedurave hetimore të nisura gjatë vitit të kaluar, si dhe leximi në mënyrë sa më optimale të të gjithë shenjave që vijnë nga ankesat, mediat e shkruara apo vizive, komuniteti i biznesit apo i konsumatorit.

Sikurse u paraqit në këtë raport janë në përfundim hetimet e thelluara në tregun e prodhimit, importit dhe të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit, në tregun e transportit qytetas Tiranë, tregu i prokurimeve publike, shërbimi i sigurisë fizike, qarku Korce, në tregun e çimentos; hetimi paraprak në tregun e telefonisë celulare. Gjithashtu do të vazhdojnë monitorimet në tregun financiar për marrëveshjet mes

bankave dhe shoqërive të sigurimit, tregun e energjisë elektrike, tregun e gazit të lengshëm natyral, tregun e farerave, fidaneve, plehrave kimike dhe të pesticideve. Fillimi i 2013 tregoi për një rritje të ndjeshme të numrit të transaksioneve të shit/blerjes së aksioneve të njoftuara pranë Autoritetit të Konkurrencës. Edhe gjatë këtij viti do të vazhdojë bashkëpunimi me QKR për të identifikuar transaksionet e përqëndrimeve që nuk janë njoftuar, i cili përbën jo vetëm një instrument të zbatimit të ligjit, por edhe një instrument të forcimit të kulturës ndaj ligjit të konkurrencës tek komuniteti i biznesit.

## **VI.2 Përafrimi i legjislacionit**

Një aspekt të rëndësishëm në procesin e draftimit të akteve të reja do të jetë hartimi i një kuadri nënligjor të përafruar me legjislacionin europian në fushën e konkurrencës. Më konkretisht gjatë vitit 2013 do të përshtaten dhe miratohen:

- 1) Rregullorja e BE-së, me indeks 32009R0487, Nr. 487/2009, datë 25 Maj 2009 “Mbi zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategori të caktuara të marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror” në pëputhje me të cilën do hartohet përkatësisht Rregullorja e “Për kategoritë e marrëveshjeve në sektorin e transportit ajror”
- 2) Rregullorja e Këshillit Europian(EC) BE-së, index 32009R0246, Nr. 246/2009, e datës 26 Shkurt 2009 “Mbi zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet shoqërive të linjave të transportit të mallrave” në pëputhje me të cilën do hartohet përkatësisht Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve në shoqëritë e linjave të transportit të mallrave”.
- 3) Njoftimi i ri i Komisionit të BE-së, index 52011XC0114(04) “Udhëzime mbi zbatimin e nenit 101 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian për marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit”, në pëputhje me të cilin do hartohet përkatësisht Udhëzimi i “Për kategoritë e marrëveshjeve në shoqëritë e linjave të transportit të mallrave”.
- 4) Udhëzimin e Komisionit Europian, index 52009XCO224(01) “Mbi zbatimin e nenin 82 të Traktatit të BE-se për sjelljen abuzive perjashtuese e ndermarrjeve me Pozite Dominuese”, në përputhje me të cilin do hartohet përkatësisht Udhëzimi “Mbi zbatimin e neneve 8 dhe 9 të Ligjit 9121 datë 23.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

## **VI.3 Forcimi i advokacisë dhe i kulturës së konkurrencës**

Në mënyrë të vazhdueshme Komisioni i Konkurrencës thekson se sa jetike është bashkëpunimi real dhe interaktiv midis institucionit të konkurrencës dhe gjithë enteve rregullatore, si mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë e tregjeve specifike.

Gjithashtu, eksperiencia e vitit të kaluar na tregoi se duhet t'i kushtohet një vemendje e veçante jo vetëm institucioneve të qeverisjes qendrore, por edhe ato vendore, të cilat luajnë një rol relativ rregullues për tregjet rajonale.

Procesi i miratimit të rregulloreve dhe udhëzimeve të sipërcituara, nëpërmjet diskutimeve publike në tryeza të rrumbullakta me palët e interesit, do të jetë një instrument tjetër që do të përdoret për rritjen dhe forcimin e advokacisë dhe kultures jo vetëm me palët e interesit, por për të gjithë publikun apo konsumatorin.

#### **VI.4. Forcimi i kapaciteteve administrative**

Për Autoritetin e Konkurrencës mbetet sfida e vazhdueshme forcimi i kapaciteteve dhe për këtë arsye për vitin 2013, për shkak të përfundimit të projekteve janë planifikuar fonde nga buxheti i shtetit (2.5 milionë lekë) për trajnime kryesisht në seminare dhe konferenca të organizuara nga OECD, ICN etj.,

